



Funded by  
the European Union



# NJË INSTRUMENT PËR MIRATIMIN ME NDJESHMËRI GJINORE TË LEJEVE PËR ARMË ZJARRI

GENDER AND SALW CONTROL: KNOW HOW SERIES

1 Shqetësimet kryesore gjinore

2 Rishikoni aplikimin nga perspektiva gjinore

3 Marrja e një vendimi të informuar dhe me ndjeshmëri gjinore

4 Monitorimi i vazhdueshëm

Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit rajonal *Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor (IPA/2021/425-067)*, me financimin e Komisionit Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, përmes Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimin.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni:

Drejtuesen e SEESAC

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000 Beograd, Serbi

Tel: +381 11 415 5300

[www.seesac.org](http://www.seesac.org)

***Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë:*** Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian, për sa i përket: 1) statusit ligjor të secilit vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) përcaktimit të vijave kufitare ose kufijve të tij.

Redaktorët: Kosana Beker, Eksperte kryesore dhe Dragan Božanić, Specialist i projektit të SEESAC për hulumtimet dhe çështjet gjinore

Përkthimi: Alba Global

Dizajni dhe faqosja: Ivan Čulafić

Printimi: Bigraf Plus, Beograd

Qarkullimi: 50 copë

Vendi dhe viti i lëshimit: Beograd, 2024

ISBN-978-86-7728-369-8

@ SEESAC 2024. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

**NJË INSTRUMENT**  
PËR MIRATIMIN ME  
NDJESHMËRI GJINORE  
TË LEJEVE PËR ARMË  
ZJARRI

# Falënderime

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për profesionistët e shumtë që kontribuan në zhvillimin e Udhëzuesit, ku bëjnë pjesë:

Ekspertët: Kosana Beker (Femplatz, Eksperte kryesore), Jasminka Friscikj (Shoqata për Emancipimin, Solidaritetin dhe Barazinë e Grave), Elona Dini (UNDP në Shqipëri), Maja Brankovic Djundić (UNDP në Serbi) dhe Viktorija Ružičić-Tokić (Konsulente).

Anëtarët e Grupit të Punës dhe përfaqësuesit e Ministrive të Brendshme dhe Policisë: Snežana Vujović, Božidar Bulatović, Ranka Jovanović, Burim Kadriu, Labinot Sadiku, Sali Berisha, Almenida Bajrami, Slavko Tunjić, Nermina Jež, Dragana Majstorović, Nikolina Savanović, Gordan Zovko, Iva Kuzevska, Svetlana Belsoska, Tanja Vasilevska, Miki Ilijevski, Lindita Lushaku, Majlinda Vathi, Elsa Zylyftari, Artur Papa.

Përfaqësuesit e Ministrive të Brendshme dhe Policisë që morën pjesë në diskutimet e grupeve të fokusit: Elsa Zylyftari, Agron Pod Gega, Fatma Kalemi, Reshat Kalaci, Kastriot Gjongecoj, Julian Cano, Silvia Binaj, Tajar Hysenaj, Adeva Kondi, Dhurata Mehmeti, Elena Hasanago, Erba Leka, Eriselda Dollani, Lindita Lushaku, Oldian Lici, Valbona Rrapaj, Miroslav Kosić, Hrvoje Pašalić, Jasmina Čunjalo, Antonija Kovačević, Amir Kuko, Kristijan Kraljević, Kalila Hrgić, Krešimir Kosić, Muamer Bajrović, Edin Musić, Samela Ribo, Zvonimir Brnić, Agron Maliqi, Bajram Ademi, Lorita Bejtullahu-Preteni, Ramadan Ahmeti, Sami Hasanaj, Sefer Muhadim, Blerim N. Krasniqi, Milazim Govori, Behxhet Krasniqi, Esat Maliqi, Mukadese Gogolli-Maloku, Shemsie Jonuzaj, Xhemile Behluli, Mirjana Cvetkovska, Emilija Damcevska, Dean Stamatovski, Nermine Izairi, Tatjana Gjurovska, Demiralija Fejzo, Biljana Jakimovska, Stefan Mihajlovic, Violeta Trpcevska, Aleksandra Deckovska, Zulfi Abdul, Burim Ademi, Nenad Dejanoski, Selman Selmanovski, Nikola Gjorgjevski, Astrit Aslani, Snežana Vujović, Alma Hot, Danijela Rajević, Dejan Bogavac, Ermila Vujošević, Jasminka Luboder, Bosiljka Palikuća, Biljana Vukčević, Dragana Jovičević, Dragica Kalezić, Jovana Nišavić, Ranka Jovanović, Petar Ivezić.

Përfaqësuesit e organizatave të grave dhe ofruesit e shërbimeve në rajon që morën pjesë në diskutimet e grupeve të fokusit: Aurela Bozo, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Marsela Allmuça dhe Marinela Muçobega, Qendra “Strehëza Edlira Haxhiymeri”, Mersida Male (Bashalliu), Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Stela Tanellari, “Të ndryshëm & Të barabartë”, Anjeza Bojaxhiu, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) për rastet e dhunës në familje, Bashkia e Tiranës, Amra Beganović, “Medica Zenica”, Mersiha Lokvančić, Fondacioni i Demokracisë Vendore, Radmila Žigić dhe Mirzeta Tomljanović, Fondacioni

“Lara” në Bjeljina, Gorica Ivić dhe Andrea Buzadžija, Fondacioni “Gratë e Bashkuara” në Banja Luka, Elmedina Sejdiu, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Elena Dimushevskaja, Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Natasha Petkovska, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Jasna Orovcanec Arangelovik, Shoqata e Avokatëve të Rinj në Maqedoni (MYLA), Leonora Dukaj, “Safe life Tuzi”, Nataša Međedović dhe Nada Koprivica, “Numri i ndihmës për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës” Nikshiq, Nada Jelovac, Tijana Vuksanović dhe Jovana Mirković, “Sigurna ženska kuća”, Zorica Konatar, “Qendra për të Drejtat e Grave”.

Përmes konsultimeve dhe vlerësimit mes ekspertëve, përfaqësuesit e organizatave të grave, si: “Numri i ndihmës për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës” Nikshiq, “Safe Women’s House” Podgoricë, Qendra “Strehëza Edlira Haxhiymeri” Tiranë, Fondacioni “Gratë e Bashkuara” Banja Luka dhe Fondacioni “Lara” Bjeljina, kanë kontribuar në zhvillimin e Udhëzuesit.

Skuadra e SEESAC e cila kontribuoi në hartimin e Udhëzuesit: Alain Lapon, Kryekëshilltar Teknik, Juliana Buzi, Koordinatore për Bashkëpunim Rajonal, Vesna Cipruš, Këshilltare e Lartë për Çështjet Gjinore, Tatjana Višacki, Analiste Projekti, Violeta Gaši, Bashkëpunëtoresh e Programit dhe Jana Ilić, Asistente e Programit.



# Tabela e përmbajtjes

<b>1.</b>	Hyrje	7
<b>1.1</b>	Procesi i zhvillimit të instrumentit	7
<b>1.2</b>	Konteksti: Përse na nevojitet ky instrument?	10
<b>2.</b>	Instrumenti	14
<b>2.1</b>	Objektivi i instrumentit	14
<b>2.2</b>	Përmbajtja e instrumentit	15
<b>2.3</b>	Hapat e miratimit me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri	15
<b>Hapi 1:</b>	Jini në dijeni të shqetësimeve kryesore gjinore në kontekstin e miratimit të lejeve për armë zjarri	18
	Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave	19
	Armët e zjarrit dhe dhuna ndaj grave	21
	Grupet që kanë më tepër gjasa për të keqpërdorur armët e zjarrit - meshkujt e rinj në moshë	22
<b>Hapi 2:</b>	Rishikoni aplikimin nga perspektiva gjinore – Verifikimet e së shkuarës	28
	Fillimi i verifikimeve të së shkuarës në momentin e marrjes së një aplikimi/kërkese	29
	Qasja ndërsektoriale	30
	Informacion i përgjithshëm rreth aplikantit	31
	Arsyeja për marrjen e armëve të zjarrit	34
	Precedentët penalë dhe kundërvajtjet	34
	Regjistrat operacionale të policisë	36
	Të dhënat nga regjistri i armëve të zjarrit	37
	Vizitat në terren dhe intervistat	38
<b>Kutia 1:</b>	Kryeni hetime të tjera, duke përfshirë kontrollin e mediave sociale dhe të aktivitetit në internet	50
<b>Hapi 3:</b>	Marrja e një vendimi të informuar dhe me ndjeshmëri gjinore	52
<b>Hapi 4:</b>	Monitoroni në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e kushteve ligjore për zotërimin e armëve	58

# 1. Hyrje

## 1.1 Procesi i zhvillimit të instrumentit

Në kuadër të projektit rajonal “Mbështetje për përmirësimin e luftës kundër zotërimit të jashtëligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor”, të financuar nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, përmes Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), SEESAC po ofron mbështetje për autoritetet në Ballkanin Perëndimor për të integruar perspektivën gjinore në masat për kontrollin e AVL-ve. Në këtë kontekst, zbatohet një paketë me aktivitete gjithëpërfshirëse për të përmirësuar përgjigjen institucionale ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, ku përfshihet rregullimi i zotërimit të armëve të zjarrit, si dhe procedurat dhe praktikrat e lidhura me miratimin e lejeve për armë zjarri.

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me autoritetet e Ballkanit Perëndimor, në vitin 2022, SEESAC nisi krijimin e Grupit Rajonal të Punës për zhvillimin e një instrumenti për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri.

Grupi i Punës ka si qëllim që:

- ▶ Të kontribuojë në rritjen e njohurive rreth sfidave kryesore në miratimin e lejeve për armë zjarri, në lidhje me parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, si dhe përmes trajtimit të shqetësimeve të tjera gjinore,
- ▶ Të zhvillojë një instrument praktik për të garantuar se procedurat e lëshimit të lejeve marrin plotësisht në konsideratë rreziqet e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim, si dhe aspektet e tjera gjinore të armëve të zjarrit, duke përfshirë shqetësimet e lidhura me grupin më të rrezikuar ndaj keqpërdorimit të armëve të zjarrit, pra meshkujt e rinj në moshë.



Takimi i parë u organizua në Tiranë, nga data 30 nëntor deri më 1 dhjetor 2022, me pjesëmarrjen e 15 profesionistëve përgjegjës për miratimin e lejeve për armë zjarri nga pesë juridiksione të Ballkanit Perëndimor: Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë, Shkup dhe Tiranë.<sup>1</sup> Grupi i punës diskutoi sfidat kryesore në lidhje me parandalimin e dhunës në familje përmes procedurave të dhënies së lejeve për armë zjarri dhe nisi zhvillimin e instrumentit për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri. Për të mbështetur Grupin e Punës, SEESAC realizoi një hartëzim të praktikave të mira në rregullimin e miratimit të lejeve për armë zjarri, me qëllim parandalimin e dhunës në familje, i cili u prezantua dhe u diskutua gjatë seminarit.

Për të zgjeruar bazën e të dhënave të instrumentit, u organizuan pesëmbëdhjetë (15) grupe fokusi për të marrë kontribute lidhur me zhvillimin e tij dhe për të diskutuar mënyrat e përshtatshme të trajtimit të rreziqeve të lidhura me praninë e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje. Grupet e fokusit u realizuan në Sarajevë nga data 28 deri në 30 mars; në Tiranë nga data 28 deri në 30 mars; në Podgoricë nga data 4 deri në 6 Prill; në Prishtinë nga data 12 deri në 14 prill; dhe në Shkup nga 25 deri në 27 prill. Në çdo juridiksion u organizuan tre grupe fokusi: me përfaqësues të organizatave të grave (morën pjesë në total 17 organizata), me oficerët e policisë që merren me miratimin e lejeve për armë zjarri (33) dhe me oficerët që u përgjigjen rasteve të dhunës në familje (35). Në vijim të diskutimeve të grupeve të fokusit, u zhvilluan 15 raporte gjithëpërfshirëse që kontribuuan në zhvillimin e instrumentit.

Takimi i dytë i Grupit të Punës u organizua nga data 9 deri në 11 maj 2023, në Durrës. Krahas përfaqësuesve nga takimi i parë, në takimin e dytë morën pjesë oficerë police me përvojë praktike në kryerjen e verifikimeve të së shkuarës gjatë procesit të lëshimit të lejeve për armë zjarri për civilët. Gjatë takimit u diskutuan gjetjet nga grupet e fokusit dhe u analizuan me detaje, nga perspektiva gjinore, hapat kryesore në shqyrtimin e aplikimeve për armë zjarri. U diskutuan gjithashtu struktura dhe përmbajtja e instrumentit.

Bazuar në të dhënat dhe kontributet nga Grupi i Punës, praktikat e mira ekzistuese në rajon, si dhe gjetjet nga grupet e fokusit, SEESAC zhvilloi një draft të instrumentit, i cili përcaktonte strukturën dhe përmbajtjen, si dhe nënvizonte hapat kryesorë që duhet të trajtohen për të garantuar një qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj miratimit të lejeve për armë zjarri dhe për të parandaluar keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, në dhunën ndaj grave dhe në dhunën me bazë gjinore.

<sup>1</sup> Duke qenë se autoritetet në Beograd kanë zhvilluar më parë udhëzime të ngjashme me mbështetjen e UNDP-së në Serbi përmes projektit "Redukto rrezikun-Rrit sigurinë - Drejt zhdukjes së keqpërdorimit të AVL-ve në kontekstin e dhunës në familje", përfaqësuesit e Beogradit nuk morën pjesë në aktivitetet e Grupit të Punës, por ndanë me Grupin e Punës mësimet e nxjerra dhe praktikat e mira të zhvilluara në kuadër të këtij projekti, të cilat u integruan në këto Udhëzime.

Gjithashtu, u mbajtën konsultime me organizatat e grave me qëllimin për të shqyrtuar më tej masat e propozuara në Udhëzime lidhur me sigurinë e grave që i kanë mbijetuar dhunës në familje.

Përveç kontributeve të vlefshme nga Grupi i Punës, instrumenti përfiton nga një gamë e gjerë praktikash të mira në këtë fushë. Kjo lidhet në veçanti me *Udhëzuesin e Mbretërisë së Bashkuar (MB) për Ligjin e lejeve për armë zjarri (2016)*, si dhe me një sërë masash të sugjeruara që janë integruar në këtë instrument dhe që janë përshtatur sipas kontekstit specifik në rajon. Gjithashtu, instrumenti mbështetet në produktet e njohurisë të zhvilluara në kuadër të projektit *Redukto rrezikun, Rrit sigurinë - Drejt zhdukjes së keqpërdorimit të AVL-ve në kontekstin e dhunës në familje*, të zbatuar nga UNDP në Serbi. Për më tepër, janë përfshirë edhe përvojat nga Australia, Kanadaja dhe Zelanda e Re.

## 1.2 Konteksti: Përse na nevojitet ky instrument?

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit vazhdon të përbëjë një kërcënim serioz ndaj sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve në Ballkanin Perëndimor, si të grave po ashtu edhe të burrave. Ai nxit dhunën në familje dhe krimin, si dhe cenon qëndrueshmërinë, duke penguar kështu zhvillimin e përgjithshëm.

Vetëm gjatë vitit 2022, janë vrarë 129 persona dhe janë plagosur 318 persona me armë zjarri. 467 persona të tjerë janë kërcënuar, çka u ka shkaktuar pasoja të rënda psikologjike dhe trauma.<sup>1</sup> Vrasjet në masë të kohëve të fundit në rajon, disa prej të cilave janë kryer me armë zjarri në pronësi të ligjshme, kanë pasur ndikime shkatërrimtare dhe afatgjata te qytetarët, familjet dhe komunitetet. Nuk është habi që 78% e qytetarëve të anketuar në Ballkanin Perëndimor në vitin 2023 ndiheshin të kërcënuar nga zotërimi dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit në lagjen e tyre, çka nënkupton se problemet e lidhura me armët e zjarrit zënë vendin e parë në listën e shqetësimeve të sigurisë në rajon.

Ndikimi i ndryshëm i keqpërdorimit të armëve të zjarrit te gratë dhe burrat është i qartë dhe i mirëstudiuar. Burrat përbëjnë 99% të autorëve të incidenteve me armë zjarri. Ata gjithashtu përbëjnë shumicën e viktimave të incidenteve me armë zjarri, përkatësisht 81%, krahasuar me 19% të grave. Meshkujt e rinj në moshë janë grupi më i rrezikuar nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit. Ata janë përgjegjës për pothuajse gjysmën e të gjithë autorëve të incidenteve me armë zjarri, si dhe janë grupi me më shumë gjasa për të qenë viktimat të keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Pavarësisht se burrat janë më tepër në rrezik nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit në mosmarrëveshjet dhe grindjet në publik, si dhe në kontekstin kriminal, gratë ndikohen në mënyrë joproporcionale nga përdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje.

Shpeshherë, armët e zjarrit janë mjeti i zgjedhur në kryerjen e dhunës në familje. Sipas studimit të kryer në rajon, 37,7% e vrasjeve të kryera nga anëtarët e familjes janë kryer me armë zjarri, ndërsa 43,5% e të gjitha grave të vrara nga një partner intim në Evropën Juglindore janë vrarë me armë zjarri.<sup>2</sup> Për sa i përket shkallës së problemit, të dhënat e SEESAC dokumentojnë një tendencë të vazhdueshme, **pra që çdo vit vriten më shumë njerëz me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje se sa në çdo lloj incidenti tjetër, duke përfshirë në kontekstin kriminal, në mosmarrëveshjet në publik dhe nga të shtënat për shkaqe të papërcaktuara.** Në Evropën Juglindore, 77% e të gjitha grave të vrara me armë zjarri janë vrarë nga pjesëtarët meshkuj të familjes, kryesisht nga partneri intim aktual ose i mëparshëm.<sup>3</sup>

Gjithashtu, zotërimi dhe kërkesa për armë zjarri kanë natyrë thellësisht gjinore. Në Evropën Juglindore, **burrat zotërojnë 97,2% të të gjitha armëve të zjarrit në pronësi të ligjshme**, ndërsa gratë vetëm 2,8%.<sup>4</sup> Deri në njëfarë mase, këto dallime reflektohen në qëndrimet ndaj pronësisë së armëve të zjarrit. **Burrat kanë shumë më tepër gjasa se gratë që të deklarojnë se do të zotëronin një armë.** Kjo është veçanërisht e vërtetë për meshkujt e rinj në moshë, të cilët janë më të prirur të zotërojnë një armë zjarri krahasuar me burrat nga grupmoshat e tjera. Predispozita më e lartë e burrave për t'u përfshirë në sjellje të rrezikshme, si dhe në incidente të dhunshme, shpesh njihet si **sindroma e meshkujve të rinj** dhe si e tillë, kërkon vëmendje dhe reagim të përshtatshëm në kuadër të kontrollit të armëve të zjarrit.

Gjatë kohëve të fundit, është përhapur ideja se për të luftuar në mënyrë efektive keqpërdorimin e armëve të zjarrit dhe për të kontrolluar përhapjen e tyre, duhet të merren plotësisht në konsideratë rreziqet e ndryshme me të cilat përballen gratë dhe burrat në lidhje me armët e zjarrit, si dhe modelet e ekspozimit të tyre ndaj dhunës me armë zjarri, dhe përvoja e përgjithshme me armët e zjarrit. Rrjedhimisht, **perspektiva gjinore duhet të integrohet plotësisht në çdo aspekt të kontrollit të armëve të zjarrit, në veçanti në rregullimin dhe kontrollin e zotërimit të armëve të zjarrit nga civilët.**

Kjo është veçanërisht e vërtetë për **procedurat dhe praktikat e lidhura me miratimin e lejeve për armë zjarri, pasi ato kanë një rol thelbësor** në parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje, dhunën ndaj grave, si dhe dhunën me bazë gjinore në një kontekst më të gjerë.

Analiza gjinore në shkallë të gjerë, e realizuar nga SEESAC në vitin 2021, lidhur me legjislacionin dhe politikat për kontrollin e armëve të vogla në Ballkanin Perëndimor, dokumentoi dispozita të qëndrueshme ligjore, kryesisht në **ligjet për armët**, si dhe në ligjet për mbrojtjen nga dhuna në familje, të cilat kanë si qëllim krijimin dhe rregullimin e procedurave për parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.

Kjo do të arrihet kryesisht përmes:

- ▶ Kufizimit të aksesit tek armët e zjarrit për aplikantët (civilët) që kanë ushtruar dhunë në familje ose që rrezikojnë të ushtrorjnë dhunë në familje,
- ▶ Sekuestrimit të armëve të zjarrit dhe revokimit të lejeve për armë zjarri, kur armët e zjarrit janë në pronësi të një personi që ushtron dhunë në familje.

Në këtë drejtim, ligjet për armët vendosin kritere gjithëpërfshirëse kualifikimi, ku parashikohet, *ndër të tjera*, se çdo aplikant që kërkon miratim për të marrë armë zjarri nuk duhet të jetë dënuar ligjërisht për vepra penale, duke përfshirë për dhunë në familje apo kundërvajtje me elemente të dhunës, ose që ndaj aplikantit të mos jetë nisur asnjë procedurë për veprë penale apo për kundërvajtje. Gjithashtu, aplikimi do të refuzohet nëse ka rrethana që tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, duke përfshirë në kontekstin e dhunës në familje ose të shkeljes së rendit dhe sigurisë në komunitet. Në rast se një civil zotëron armë zjarri të ligjshme, atëherë materializimi i një prej rrethanave të mësipërme do të çojë në sekuestrimin e armëve të zjarrit dhe revokimin e lejes së personit të pajisur me leje.

Pavarësisht se ligjet për armët dhe aktet nënligjore shoqëruese vendosin një bazë të shëndoshë për të parandaluar pajisjen me armë zjarri të një aplikanti të papërshtatshëm, analiza identifikoi disa sfida të përbashkëta në juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, të cilat kërkojnë një përgjigje të përshtatshme. Këto sfida janë diskutuar gjerësisht nga Grupi i Punës.

Dispozitat aktuale parandalojnë në mënyrë efikase blerjen ose mbajtjen e armëve të zjarrit nëse ndaj personit është dhënë një dënim për dhunë në familje, qoftë si veprë penale ose si kundërvajtje, nëse personi është denoncuar më parë për dhunë në polici, ose nëse ka të dhëna të tjera të sjelljes së dhunshme, duke përfshirë ato të identifikuarat përmes verifikimeve të së shkuarës. Megjithatë:

1. Ndryshe nga veprat e tjera penale, **shumica e rasteve të dhunës në familje nuk raportohen tek institucionet përkatëse**. Vetëm 7% e grave viktime të dhunës së ushtruar nga partneri aktual kanë kontaktuar policinë pas incidentit më të rëndë të dhunës; vetëm 15% e grave viktime të dhunës së ushtruar nga ish-partneri kanë kontaktuar policinë dhe vetëm 19% e viktimave të dhunës së ushtruar nga jopartneri kanë kontaktuar policinë.<sup>5</sup> Si pasojë, shumica e rasteve të dhunës në familje nuk mund të verifikohen në mënyrë efektive përmes të dhënave për veprat penale ose kundërvajtjet, apo nëpërmjet regjistrave të policisë. Rrjedhimisht, për të realizuar një vlerësim të besueshëm të faktit nëse një armë zjarri mund të keqpërdoret në kontekstin e dhunës në familje, është e nevojshme që çdo verifikim i së shkuarës të marrë në konsideratë këto specifika dhe të mos kufizohet vetëm në informacionin e disponueshëm në bazat e të dhënave. Raportimet e paraqitura në komisariatet e policisë për dhunë në familje dhe dhunë ndaj grave, të cilat janë përmbyllur me dhënien e një paralajmërimi ndaj autorit, nuk ndikojnë detyrimisht në vendimin për armët që ata zotërojnë.
2. Edhe nëse raportohen, **akuzat penale për dhunë në familje shpeshherë pushohen** për arsye të ndryshme, veçanërisht për shkak të provave të pamjaftueshme ose

tërheqjes së viktimave nga procesi. Për sa i përket përgjigjes së drejtësisë penale, është dokumentuar një prirje e përgjithshme që tregon mbizotërimin e dënimeve të pezulluara, veçanërisht përmes lirimit me kusht. Rrethanat lehtësuese janë rregullisht të pranishme në dhënien e vendimeve, çka tregon mungesën e njohurive mbi specifikat e dhunës në familje, natyrën e saj me bazë gjinore dhe marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit midis abuzuesit dhe viktimës. Për më tepër, shtyrja e procedurave të ndjekjes penale mund t'i japë kohë autorit që të ketë akses tek armët e zjarrit dhe rrjedhimisht, mund të rrisë rreziqet e pasojave fatale. Janë dokumentuar gjithashtu dënime më të ulëta se minimumi i kërkuar me ligj dhe raste ku policia ka dhënë vetëm paralajmërime për incidentet e dhunës në familje.

3. Verifikimet e së shkuarës nuk përfshijnë detyrimisht intervistat me partnerët aktualë dhe të mëparshëm, si dhe me anëtarët e tjerë të familjes, të cilët mund të japin informacione nëse blerja e armëve të zjarrit do të krijonte frikë të arsyeshme te partneri intim ose te fëmijët, si pasojë e përdorimit të armëve të zjarrit në çfarëdo formë të dhunës në familje. Shpeshherë, oficerët e policisë nuk janë të trajnuar siç duhet për të zhvilluar këto intervista delikate.
4. Në mënyrë të ngjashme, ligjet për armët dhe aktet përkatëse nënligjore nuk përmbajnë dispozita specifike ku të parashikohet detyrimi që një institucion kompetent të njoftojë bashkëshorten ose anëtarë të afërt të familjes kur një individ aplikon për leje për armë zjarri, edhe pse marrja e armëve të zjarrit mund t'i vendosë në rrezik këta persona.
5. Dhuna në familje shpesh barazohet me dhunën fizike, ndërsa formave të tjera të dhunës si psikologjike, emocionale, seksuale dhe ekonomike, duke përfshirë keqpërdorimit të armëve të zjarrit në këtë kontest, shpesh nuk u jepet i njëjti prioritet.
6. Shpeshherë, vendimet për një urdhër të përkohshëm mbrojtjeje të lëshuar për të parandaluar aktet e dhunës në familje nuk parashikohen shprehimisht si pjesë e kërkesave për verifikimin e sigurisë.
7. Gjithashtu, analiza dokumentoi përgjigje shumë të kufizuara ndaj rreziqeve të lidhura me meshkujt e rinj në moshë, kryesisht përmes përcaktimit të një pragu të moshës minimale në kriteret e kualifikimit.

**Në kontekstin e këtij instrumenti, termi “leje” i referohet gjithashtu licencave dhe autorizimeve, në varësi të dispozitave përkatëse ligjore në secilin juridiksion të Ballkanit Perëndimor.**

# 2. Instrumenti

## 2.1 Objektivi i instrumentit

Ky instrument synon të mbështesë profesionistët e përfshirë në miratimin e lejeve për armë zjarri që të trajtojnë sfidat e përmendura më sipër, të integrojnë perspektivën gjinore në të gjithë procesin e miratimit të lejeve për armë zjarri dhe në këtë mënyrë:

- ▶ Të parandalojnë në mënyrë efektive keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në veçanti, duke marrë në konsideratë rrethanat që mund të përbëjnë faktorë rreziku.
- ▶ Të parandalojnë keqpërdorimin e armëve të zjarrit nga grupet që kanë më shumë gjasa për t'u përfshirë në sjellje të tilla, në veçanti meshkujt 18 deri në 30 vjeç.

Duke mbështetur zbatimin efektiv të dispozitave ligjore përkatëse dhe të prioriteteve strategjike, instrumenti synon të kontribuojë në eliminimin e dhunës me bazë gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe të rrisë sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe burrave në Ballkanin Perëndimor.

**Për këtë arsye, instrumenti synon kryesisht të mbështesë integrimin e perspektivës gjinore në veprimtaritë që realizohen nga oficerët e caktuar, pa pasur si qëllim zëvendësimin e procedurave standarde të veprimit. Prandaj, instrumenti duhet të konsiderohet kryesisht si një ndihmë për profesionistët për të trajtuar më mirë shqetësimet gjinore në veprimtaritë e tyre të përditshme dhe bazohet në procedurat ekzistuese.**

## 2.2 Përmbajtja e instrumentit

Instrumenti përfshin një grup **listash kontrolli praktike** që synojnë të ndihmojnë profesionistët përkatës për të marrë në konsideratë perspektivën gjinore në çdo hap të procesit të miratimit të lejeve për armë zjarri dhe për të vlerësuar më mirë nëse:

- ▶ Armët e zjarrit mund të keqpërdoren për dhunë në familje, dhunë ndaj grave dhe dhunë me bazë gjinore, si dhe
- ▶ Rrethanat tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren nga grupet më të rrezikshme, si p.sh., meshkujt e rinj në moshë.

Bazuar në njohjen e duhur të rreziqeve të identifikuara, instrumenti synon të mbështesë profesionistët e rinj që të marrin vendime të informuara dhe të besueshme për një kërkesë për marrjen e armëve.

## 2.3 Hapat e miratimit me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri


Për të garantuar se miratimi i lejeve për armë zjarri kontribuon në mënyrë efektive në parandalimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, **perspektiva gjinore duhet të integrohet siç duhet në çdo fazë të procesit të licencimit.** Kushti paraprak kryesor për integrimin konkret të perspektivës gjinore është që të gjithë profesionistët e përfshirë të kenë njohuri të përbashkëta mbi barazinë gjinore, në veçanti mbi aspektet gjinore të kërkesës, pronësisë, përdorimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Këto njohuri të përbashkëta përfshijnë njohuritë e detajuara mbi dhunën në familje, si dhe mbi keqpërdorimin e armëve të zjarrit në këtë kontekst dhe ekspozimin ndaj dhunës me armë nga grupet që kanë më shumë gjasa të keqpërdorin armët e zjarrit, si meshkujt e rinj në moshë. Prandaj, është e nevojshme të garantohet se të gjithë profesionistët e përfshirë në çdo fazë të miratimit të lejeve për armë zjarri, të trajtohen lidhur me barazinë gjinore, dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore, si dhe mbi lidhjet midis gjinisë dhe armëve të zjarrit.

Duke pasur parasysh specifikat e diskutuara më sipër të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore dhe rëndësinë e verifikimeve të së shkuarës për të trajtuar këto sfida, perspektiva gjinore duhet të integrohet në këto verifikime pavarësisht nëse ato zhvillohen përmes bazave të të dhënave, vizitave në terren dhe intervistave, apo



ndonjë metode tjetër që mund të përdoret. Për më tepër, perspektiva gjinore duhet të integrohet plotësisht në marrjen e vendimit për çdo aplikim lidhur me miratimin e kërkesës për marrjen e një arme zjarri. Në kontekstin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, integrimi i perspektivës gjinore në verifikimet e së shkuarës dhe në procesin e miratimit të lejeve për armë zjarri, përfshin marrjen në konsideratë të cenueshmërive, përvojave, apo modeleve të veçanta të dhunës/viktimizimit të lidhura me gratë dhe burrat. Nëse aplikimi për armë zjarri është miratuar, atëherë duhet të realizohet një rishikim i vazhdueshëm për të përcaktuar nëse personi i pajisur me leje respekton plotësisht detyrimet ligjore.

Marrja e hapave në vijim do të lehtësojë përgjegjshmërinë/ndjeshmërinë gjinore të miratimit të lejeve për armë zjarri:



Në vazhdim, çdo hap shpjegohet më në hollësi.



**HAPI 1:**

**Jini në dijeni  
të shqetësimeve  
kryesore gjinore  
në kontekstin  
e miratimit të  
lejeve për armë  
zjarri**

Njohuria dhe të kuptuarit e problematikave kryesore gjinore që duhet të merren në konsideratë gjatë rishikimit të një aplikimi për marrjen e armëve të zjarrit janë parakushte për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë zjarri. Në këtë kontekst, shqetësimet kryesore gjinore që duhet të merren në konsideratë janë:

- ▶ Dhuna në familje dhe në veçanti, dhuna ndaj grave, si dhe abuzimi me armët e zjarrit në këtë kontekst,
- ▶ Keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga grupet më të prirura drejt një sjelljeje të tillë, në veçanti meshkujt e rinj në moshë.

Njohuritë e duhura rreth zanafillës, dinamikave dhe shfaqjes së dhunës në familje, natyrës së saj me bazë gjinore dhe ndikimit joproporcional te gratë, janë thelbësore për të garantuar parandalim efektiv dhe përgjigje të përshtatshme institucionale. Për të parandaluar në mënyrë efektive keqpërdorimin e armëve të zjarrit në këtë kontekst, është e nevojshme që të garantohet se të gjithë profesionistët kompetentë, të përfshirë në çdo fazë të dhënies së lejeve për armë zjarri, marrin pjesë në trajnime për barazinë gjinore, dhunën në familje, dhunën ndaj grave, si dhe për lidhjet midis gjinisë dhe armëve të zjarrit.

## Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave<sup>6</sup>

**Dhuna në familje** përbën formën më mbizotëruese dhe të përhapur të dhunës. Ajo përfshin të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes apo ambientit familjar, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve të mëparshëm apo aktualë, pavarësisht nëse autori ka jetuar ose jo në të njëjtën banesë me viktimën. Si gratë po ashtu edhe burrat mund të jenë viktima të dhunës në familje, por ajo prek gratë në mënyrë joproporcionale. **Ajo dallon nga llojet e tjera të dhunës pasi gjinia e viktimës është motivi parësor për aktet e dhunës, pra dhuna ushtrohet ndaj një gruaje për vetë faktin sepse ajo është grua, ose i prek gratë në mënyrë më shumë joproporcionale.**

Dhuna me bazë gjinore është një vepër penale dhe përbën shkelje të të drejtave të njeriut, të drejtave të jetës, lirisë, sigurisë, dinjitetit, mosdiskriminimit dhe barazisë së grave dhe burrave, si dhe të integritetit fizik dhe shpirtëror.

Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe përfshin të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që çojnë, ose

mund të çojnë, në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënimet për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngimin ose heqjen arbitrare të lirisë, pavarësisht nëse ndodh në jetën publike ose private.

Modelet dhe zanafilla e viktimizimit të grave dhe burrave në kontekstin familjar dallojnë ndjeshëm. Në kontekstin familjar, gratë janë më të rrezikuara ndaj dhunës së ushtruar nga partnerët intimë, qoftë aktualë ose të mëparshëm, ndërsa burrat janë përgjithësisht të rrezikuar nga anëtarë të tjerë të familjes, kryesisht nga anëtarët e tjerë meshkuj. Dhuna ndaj burrave zakonisht nuk ka bazë gjinore dhe lidhet me mosmarrëveshjet familjare, problemet e pronësisë, dhunën e rrënjosur ndër breza etj.

Forma më ekstreme dhe më e rëndë e dhunës ndaj grave është **femicidi**, pra **vrasja e qëllimshme, me motive gjinore, e grave dhe vajzave. Femicidi është vrasja e një gruaje nga ana e një burri për shkak të urrejtjes ndaj grave, përbuzjes, kënaqësisë, ndjesisë së pronësisë dhe pushtetit mbi gratë.**

Dhuna në familje, veçanërisht dhuna nga partneri intim, e ushtruar nga burrat, është një model sjelljeje që përdoret në çdo marrëdhënie për të fituar ose ruajtur pushtetin dhe kontrollin mbi partneren intime. Si e tillë, **dhuna në familje përbën gjithmonë abuzim të pushtetit dhe kontrollit nga autori.** Ajo karakterizohet nga një model veprimesh dhe sjelljesh abuzive që përdor një individ për të kontrolluar apo dominuar qëllimisht partneren e tij intime. Këto veprime përfshijnë kanosjen dhe kërcënimet, abuzimin emocional, izolimin, frikësimin, përdorimin e privilegjeve mashkullore<sup>2</sup> dhe të fëmijëve për të fituar dhe ruajtur kontrollin mbi partneren.

Shpeshherë, dhuna që ushtrojnë burrat ndaj grave justifikohet nga qëndrimet, normat dhe pritshmëritë sociale dhe kulturore, të cilat mbështesin përdorimin e dhunës nga burrat për të ruajtur pushtetin dhe kontrollin mbi partneren ose ish-partneren e tyre. Studimet e kanë lidhur dhunën gjinore me pranimin social të dominimit mashkullor, me krijimin e stereotipave për rolet gjinore, si dhe me pranimin e dhunës si një mënyrë normale për të zgjidhur konfliktin. **Stereotipat gjinorë mund të nxisin dhunën ndaj grave, si dhe zotërimin dhe përdorimin e armëve dhe mbizotërimi i qëndrimeve**

**2 Privilegjet mashkullore** janë sistemi i avantazheve dhe të drejtave që disponojnë burrat si pasojë e gjinisë së tyre dhe bazohet në idenë dhe praktikën e dominimit të burrave ndaj grave. Duke nënshtruar sistematikisht gratë, burrat fitojnë avantazhe ekonomike, politike, sociale, arsimore dhe praktike, të cilat në përgjithësi nuk janë të disponueshme për gratë. Dhuna në familje mund të nxisë privilegjet mashkullore në shoqërinë e ditëve të sotme. Ajo përforcon pozitën e pushtetit që u atribuohet burrave, duke bërë kështu që gratë të vazhdojnë të vuajnë pasojat e saj. Privilegjet mashkullore rriten përmes mënyrave të objektivizimit të grave, si dhe përmes perceptimit se ato kanë rolin t'u shërbejnë nevojave të partnerëve të tyre meshkuj. Burrat mund ta marrin për të mirëqenë se u takon e drejta e ushtrimit të kontrollit ndaj grave. Një gjë e tillë krijon një ndjesi autoriteti që shfaqet në formën e kanosjes, ndëshkimit dhe taktikave të kontrollit (Burimi: [Dhuna në familje dhe privilegjet mashkullore](#)).

**që mbështetin zotërimin e armëve në komunitet mund të pengojë përpjekjet për reduktimin e rasteve të dhunës në familje që përfshijnë armë zjarri.**

Rrallë ndodh që incidentet e dhunës në familje të jenë raste të izoluara dhe në përgjithësi, shpeshësia dhe ashpërsia e tyre përshkallëzohet dhe rrezikon të kulmojë në lëndime të rënda fizike ose edhe në vdekje. Për rrjedhojë, njohja e dinamikave dhe fazave të dhunës në familje është thelbësore për parandalimin e saj.

Qasjet ndaj parandalimit dhe ndërhyrjes duhet të marrin në konsideratë dinamikat komplekse të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si lloje të dhunës me bazë gjinore. Për këtë arsye, këto qasje duhet të ofrojnë mbështetje për viktimat në të gjitha fazat, si dhe duhet të fokusohen në identifikimin dhe parandalimin e përshkallëzimit të dhunës.

Anketa e udhëhequr nga OSBE<sup>7</sup> ka dokumentuar gjerësisht shkallën e problemit, duke përfshirë në Ballkanin Perëndimor, si dhe mbizotërimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave, pas moshës 15-vjeçare. **70% e grave të anketuara kanë përjetuar një formë të dhunës** pas moshës 15-vjeçare, ndërsa 31% kanë përjetuar një formë të dhunës në 12 muajt para anketës. Pothuajse një e katërta e grave të anketuara (23%) kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një partner intim pas moshës 15-vjeçare, ndërsa 60% kanë përjetuar dhunë psikologjike të ushtruar nga një partner intim. Pothuajse **gjysma e grave kanë përjetuar të paktën një formë ngacmimi seksual** dhe 10% janë përndjekur në një moment të caktuar. Siç është përmendur më parë, e njëjta anketë ka dokumentuar **nivelin e ulët të raportimit të dhunës ndaj grave.**

Edhe pse përbën formën më të përhapur të dhunës, dhuna ndaj grave, në kontekstin e dhunës në familje, zakonisht nuk raportohet në institucione.

## **Armët e zjarrit dhe dhuna ndaj grave**

**Zotërimi i një arme zjarri nga një abuzues në kontekstin e dhunës në familje rrit pushtetin dhe kontrollin e ushtruar nga abuzuesi ndaj viktimës, çka është qëllimi i tij kryesor.** Armët e zjarrit rrisin pabarazitë e pushtetit midis një viktime dhe një abuzuesi, nxisin pabarazinë gjinore dhe përforcojnë hierarkitë sociale që u japin burrave dominancë ndaj grave. Edhe pse të dhënat e lidhura me keqpërdorimin e armëve të zjarrit disponohen kryesisht për vrasjet ose plagosjet e grave, **armët e zjarrit përdoren më së shumti për kërcënime dhe frikësime.** Edhe kur armët e zjarrit nuk keqpërdoren në mënyrë të drejtpërdrejtë, thjesht prania e armëve të zjarrit është një instrument efikas

që e lejon abuzuesin të ushtrojë kontroll mbi një viktimë. **Prania e armëve të zjarrit ndikon negativisht në gatishmërinë e grave për të zbuluar dhe raportuar dhunën.** Për më tepër, prania e armëve bën që dhuna e përjetuar të raportohet me vonesë si pasojë e frikës apo kërcënimeve.

**Ka disa faktorë, të cilët rrisin mundësinë e pasojave fatale në rastet e dhunës nga partnerë intimë kur përfshihen armët e zjarrit:**<sup>8</sup> madhësia e plagëve të shkaktuara nga shtënia me armë; kapaciteti i reduktuar i grave për të bërë rezistencë; gjasat e pakta që gratë të raportojnë dhunën; shanset e reduktuara të grave për t'u arratisur ose të personave të jashtëm për të ndërhyrë dhe për t'i ndihmuar ato; dhe shanset më të larta që një abuzues të përdorë armë zjarri në rastet e dhunës në familje, veçanërisht kur gruaja po përpiqet të largohet nga abuzuesi. Rreziku i keqpërdorimit të armëve të zjarrit rritet ndjeshëm kur partneri i viktimizuar është ndarë (divorcuar, larguar) nga abuzuesi; ose kur ajo është duke marrë hapa për t'u larguar nga abuzuesi.

## Grupet që kanë më tepër gjasa për të keqpërdorur armët e zjarrit - meshkujt e rinj në moshë

**Meshkujt e rinj në moshë** janë një grup demografik që në përgjithësi ka gjasat më të larta për t'u përfshirë në sjellje të rrezikshme dhe aktivitete kriminale, të cilat shpeshherë përfshijnë edhe përdorimin e armëve të zjarrit. Meshkujt e rinj, të grupmoshës 15-30 vjeç, kanë më shumë gjasa të keqpërdorin armët e zjarrit krahasuar me meshkujt nga grupmoshat e tjera.

**Në Evropën Juglindore, një në dy incidente me armë zjarri kryhet nga meshkujt e rinj në moshë.** Burrat e grupmoshës 16 deri në 24 vjeç kanë shumë më tepër gjasa se burrat e grupmoshave të tjera që të raportojnë se kanë pasur përvoja me armët e zjarrit gjatë kohëve të fundit. Predispozita që kanë meshkujt në mes ose në fund të adoleshencës dhe në të njëzetat dhe veçanërisht ata që janë të pamartuar dhe të papunësuar, për t'u përfshirë në konflikte të dhunshme për të zgjidhur çështje në dukje të parëndësishme, për të "ruajtur imazhin e tyre", për të dëmtuar një rival, ose për të rritur statusin e tyre social, zakonisht njihet me termin **sindroma e meshkujve të rinj.**<sup>9</sup> Shpeshherë, ky model sjelljeje çon në një probabilitet më të lartë të keqpërdorimit të armëve të zjarrit nga individët në këtë grup demografik. Për më tepër, një sërë hulumtimesh kanë dokumentuar lidhjet ndërmjet normave të caktuara të burrërisë dhe sjelljes së dhunshme.<sup>10</sup>

**Keqpërdorimi i armëve të zjarrit ka natyrë thellësisht gjinore.** Në Evropën Juglindore,

**burrat zotërojnë 97,2% të të gjitha armëve të zjarrit në pronësi të ligjshme**, ndërsa gratë vetëm 2,8%. Burrat e grupmoshës 18-35 vjeç zotërojnë 19,9% të të gjitha armëve të zjarrit që zotërohen nga burrat.<sup>11</sup> Përqindja dominuese e burrave në totalin e zotëruesve të armëve të zjarrit është rritur me kalimin e kohës dhe pasqyrohet nga përqindja e lartë e burrave që marrin leje të reja çdo vit. Gjatë periudhës 2012-2016, burrat morën 97% të të gjitha lejeve të reja, krahasuar me 3% të lejeve të marra nga gratë. Deri në njëfarë mase, këto dallime reflektohen edhe në qëndrimet ndaj pronësisë së armëve të zjarrit. Të dhënat e anketimit rajonal të kryer në vitin 2017 treguan se **burrat kanë dy herë më shumë gjasa se gratë për të pranuar se do të zotëronin një armë. Kërkesa për armë zjarri dominohet kryesisht nga burrat.**

Gjatë kohëve të fundit, studimi mbi ekspozimin e burrave ndaj dhunës së armatosur ka hedhur dritë mbi lidhjet ndërmjet perceptimit mbizotërues të burrërisë, si dhe kërkesës dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit.

**Perceptimi mbizotërues i burrërisë** i referohet një grupi atributesh, sjelljesh dhe rolesh që zakonisht janë të lidhura me djemtë dhe burrat në një kontekst të caktuar social, kulturor dhe historik. Kjo tërësi besimesh, të cilat përcillen nga prindërit, familjet, media, bashkëmoshatarët dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë, ushtron trysni mbi burrat për t'u sjellë në përputhje me disa pritshmëri të caktuara.<sup>12</sup> Këto trysni u transmetojnë burrave mesazhin se duhet të jenë të pavarur, të sillen si të fortë, t'u qëndrojnë besnikë roleve strikte gjinore, të jenë të përgatitur që të përdorin dhunë për të zgjidhur konfliktet dhe të mos shfaqin shenja feminiteti. Këto sjellje dhe role të lidhura me maskilizmin apo burrërinë, zakonisht e vënë theksin te forca, në veçanti tek ajo fizike, guximi, gatishmëria për të marrë përsipër rreziqe, pavarësia, vetësiguria, arritjet, ashpërsia, stoicizmi, suksesi, si dhe te fakti që mashkulli duhet të sigurojë jetesën, të mos duket i dobët, të ndërmarrë rreziqe dhe të përfshihet në sjellje të rrezikshme. Studimet tregojnë se respektimi i këtyre mesazheve dhe trysnive mund të lidhet me ushtrimin dhe përjetimin e shumë formave të dhunës, si dhe me shumë sjellje të tjera të dëmshme. Gjithashtu, përfshin përdorimin e dominancës, dhunës, dhunës seksuale dhe kontrollit për të vendosur pushtetin dhe superioritetin e tyre.<sup>13</sup> **Për më tepër, pushteti dhe kontrolli janë kategori bazë për të përkufizuar perceptimin mbizotërues të burrërisë.**<sup>14</sup>

Në këtë kontekst, armët e zjarrit mund të jenë veçanërisht tërheqëse për meshkujt e rinj në moshë pasi shpeshherë, ata i lidhin armët me burrërinë dhe në veçanti, me ushtrimin e pushtetit dhe të kontrollit.<sup>15</sup> Meshkujt e rinj në moshë shpesh i shohin armët e zjarrit si mjete për të arritur statusin social dhe ekonomik që ata besojnë se meritojnë. Burrat, të cilëve u janë mohuar rrugët normale drejt përparimit social dhe ekonomik, shfaqen



veçanërisht të ndjeshëm ndaj tërheqjes simbolike të armëve të zjarrit. Tërheqja simbolike e armëve të zjarrit mund të jetë shumë e fortë, veçanërisht në rastin e meshkujve e rinj në moshë. Përveç shfaqjes së pushtetit dhe kontrollit, armët e zjarrit mund të jenë të lidhura gjithashtu me përmbushjen e pritshmërive mbi rolet gjinore dhe reputacionin në komunitet, ose mund të përdoren për t'iu përgjigjur sfidave të perceptuara ndaj statusit dhe "burrërisë". Autorët e rinj në moshë shpesh e shohin një armë si një mjet për të "mbrojtur statusin e tyre si persona të cilëve duhet t'ua kesh frikën dhe të cilët nuk duhen kundërshtuar". Dëshmitë anekdotike tregojnë se armët e zjarrit kanë qenë gjithashtu pjesë e riteve të kalimit të djemve të rinj në moshën e pjekurisë.

Në Evropën Juglindore, burrat e grupmoshave më të reja janë më të prirur që të zotërojnë një armë zjarri krahasuar me burrat e grupmoshave të tjera. **60,5% e burrave të grupmoshës 16-24 vjeç besojnë se do të ndiheshin më të sigurt me një armë zjarri në shtëpi.**<sup>16</sup>

Studimet e mëparshme<sup>17</sup> në EJK tregojnë se ekzistojnë disa faktorë të cilët, në varësi të shkallës së tyre, mund të ndikojnë në kërkesën e burrave për armë zjarri: perceptimi i tyre mbi sigurinë në komunitet, funksioni i perceptuar i armëve të zjarrit, pra për mbrojtje personale, për qëllime gjuetie dhe sportive, pritshmëritë sociale nga meshkujt (tradita, "një burrë duhet të mbajë një armë zjarri", "nxit frikë tek të tjerët", "ndjesia e pafuqisë sociale dhe ekonomike dhe nevoja për të rivendosur pushtetin përmes përdorimit të armëve, nevoja për të qenë në përputhje me perceptimin mbizotërues të burrërisë, mjet për të fituar pushtet" etj.), përvoja me armët e zjarrit ose, nëse u referohemi karakteristikave socio-demografike të këtyre të anketuarve, mosha në veçanti.<sup>18</sup>

Krahas natyrës gjinore që ka dhuna, duke përfshirë dhunën me armë, është po aq e rëndësishme që të mos nënvlerësohet roli i kontekstit më të gjerë social dhe tërësia komplekse e faktorëve të tjerë që përcaktojnë nëse meshkujt e rinj në moshë mund të përdorin dhunë.<sup>19</sup> Mes këtyre faktorëve, studiuesit theksojnë kushtet shtrënguese dhe kontrollin e dhunshëm prindëror, kontrollin e kufizuar prindëror, socializimin me bashkëmoshatarë kriminelë, të qenit të dhunuar, të qenit dëshmitarë të dhunës ose përjetimin e dhunës në shtëpi ose komunitet, aftësitë e kufizuara sociale; të pasurit e pikëpamjeve më tradicionale ose të ngurta në lidhje me gjininë, perceptimi i qëllimeve armiqësore tek të tjerët, ushtrimi i dhunës dhe perceptimi se ajo nxit respekt, çrregullimet e stresit post-traumatik etj. Për rrjedhojë, gjinia është një faktor i rëndësishëm parashikues, por hyn në lojë vetëm nëse janë të pranishëm një sërë faktorësh të tjerë socialë. Lidhjet midis disa prej pritshmërive të burrërisë dhe armëve të zjarrit rrisin rrezikun që disa nëngrupe të meshkujve (kryesisht të rinjtë, por jo vetëm), të përdorin armë, si dhe të

jenë viktime të dhunës me armë.

Faktorët specifikë që i vendosin meshkujt (e rinj) në rrezik ose që nxisin sjelljet e rrezikshme duhet të merren gjithashtu në konsideratë gjatë shqyrtimit të një kërkesë për miratimin e lejes për armë zjarri, nëse një aplikant i përket këtij grupi demografik. Kjo duhet të bëhet përmes shqyrtimit të çdo aspekti të lejes: kontrolli i bazave përkatëse të të dhënave, verifikimet e së shkuarës në terren dhe kontrolle mjekësore, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.





HAPI 2:

# Rishikoni aplikimin nga perspektiva gjinore – Verifikimet e së shkuarës

## Fillimi i verifikimeve të së shkuarës në momentin e marrjes së një aplikimi/kërkese

Në momentin që merret një aplikim/kërkese për lëshimin e miratimit për marrjen e një arme zjarri, së bashku me evidencat e parashikuara në ligjin “Për armët”, një oficer i caktuar ose një njësi organizative nis një verifikim sistematik dhe gjithëpërfshirës të së shkuarës dhe të përmbushjes së kriterëve ligjore, siç parashikohet nga ligji ose nga aktet nënligjore përkatëse. **Kini parasysh se të gjitha procedurat e diskutuara në këtë seksion vlejné gjithashtu për çdo rinovim të një lejeje për armë zjarri.**

Synimi i verifikimit të së shkuarës është të përcaktojë nëse aplikanti përmbush plotësisht kriteret e kualifikimit të parashikuara në ligjin “Për armët” dhe të ofrojë një vlerësim të besueshëm të faktit nëse personi mund të paraqesë rrezik për veten, personat e tjerë ose sigurinë publike, si dhe nëse ekzistojnë rrethana të cilat mund të tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, duke përfshirë në dhunën në familje.

Duke pasur parasysh specifikat e dhunës në familje dhe sfidat që paraqet kjo çështje gjatë shqyrtimit të një aplikimi të diskutuar më sipër, një verifikim i së shkuarës luan një rol thelbësor për të vlerësuar nëse marrja e një arme zjarri mund të shoqërohet me keqpërdorimin e saj kundrejt partnerëve intimë ose anëtarëve të tjerë të familjes. Një vendim në lidhje me kërkesën për të marrë një armë zjarri nuk duhet të mbështetet vetëm në bindjet e krijuara gjatë kohës kur vlerësohet nëse aplikantët janë të përshtatshëm për të zotëruar armë zjarri pa përbërë rrezik ndaj sigurisë së publikut, vetes dhe njerëzve të tjerë, duke përfshirë ndaj partnereve të tyre dhe anëtarëve të familjes. Përdorimi i gjerë i burimeve të ndryshme të informacionit është thelbësor në zbutjen e rrezikut për të parandaluar keqpërdorimin e mëtejshëm të armëve të zjarrit nga personat e pajisur aktualisht me leje dhe ata që mund të pajisen në të ardhmen.

Verifikimi i së shkuarës mbështetet në disa burime informacioni:

- ▶ precedentët penalë dhe kundërvajtjet, regjistrat e policisë, vendimet e gjykatës dhe bazat e të dhënave të tjera zyrtare,
- ▶ informacioni i mbledhur përmes punës në terren nga një oficer i caktuar i policisë, ku përfshihet informacioni nga qendrat e mirëqenies sociale dhe organizatat e specializuara që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje (linjat telefonike/shërbimet e ndihmës, strehëzat etj.).

- ▶ burime të tjera, duke përfshirë praninë në mediat sociale dhe aktivitetin në internet.

**Shënim: Lista e sugjeruar e pyetjeve ka si qëllim të plotësojë listën e kontrollit që përdoret aktualisht dhe nuk synon në asnjë mënyrë që ta zëvendësojë atë.**

## Qasja ndërsektorale

Njësitë e policisë për dhunën në familje duhet të konsultohen në çdo fazë të procesit të verifikimit të së shkuarës. Qasja ndërsektorale mund të jetë e nevojshme për të vlerësuar siç duhet nëse aplikanti mund të mbajë një armë zjarri pa rrezikuar sigurinë ose qetësinë publike.

Në këtë aspekt, konsultimi me një njësi për dhunën në familje (ose me oficerin e caktuar të policisë, nëse nuk ka një njësi të tillë) mund të lehtësojë kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës lidhur me rrethanat që tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren në dhunën në familje.

Në rast se nevojitet më shumë informacion për një vlerësim të përshtatshëm, mund të jetë e dobishme të konsultoheni me:

- ▶ grupet e koordinimit dhe bashkëpunimit, ose me mekanizmat e referimit (në varësi të juridiksionit),
- ▶ Qendrën e Mirëqenies Sociale që mund të jetë në dijeni të situatës familjare dhe historikut të aplikantit, si dhe që mund të ketë informacione rreth historikut të dhunës në familje,
- ▶ Linjat telefonike/shërbimet e ndihmës, strehëzat dhe organizatat e tjera të grave, të cilat ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës (në familje),
- ▶ mjekun e familjes.

Po ashtu, në rastin e aplikimeve të paraqitura nga individë nën moshën 30 vjeç, mund të jetë e dobishme përfshirja e oficerëve të policisë që merren me veprat penale të kryera nga persona të mitur, për të vlerësuar më mirë rreziqet e mundshme.

Edhe pse bashkëpunimi ndërsektorial mund të ndodhë në çdo fazë të procesit të miratimit të lejes për armë zjarri, ky bashkëpunim duhet të planifikohet që në fillim të procesit për të pasur rezultate maksimale.

## Informacion i përgjithshëm rreth aplikantit

Gjatë verifikimit të pajtueshmërisë me kërkesat e përgjithshme të përcaktuara nga ligji “Për armët”, përmes bazave të të dhënave të menaxhuara nga institucionet përkatëse, sigurohuni që të kontrollohen aspektet në vijim:

- ▶ Çdo ndryshim ligjor i emrit dhe/ose mbiemrit,
- ▶ Shtetësia e mëparshme ose e dyfishtë, duke përfshirë faktin nëse janë ndërmarrë hapa ligjorë për ndryshimin e shtetësisë,
- ▶ Vendbanimet e aplikantit në 10 vitet e fundit. Përveç rasteve kur bazat e të dhënave janë të centralizuara, kryeni një hetim në departamentet e policisë në vendbanimet e mëparshme të aplikantit,
- ▶ Niveli arsimor dhe institucionet arsimore të frekuentuara,
- ▶ **Gjendja civile/e marrëdhënies.** Përveç të dhënave mbi partnerin/en aktual/e, kërkoni nga aplikanti që të japë të dhëna për çdo **ish bashkëshort/e ose partner/e** me të cilin/cilën ajo/ai ka pasur një marrëdhënie në 5 vitet e fundit, si dhe për anëtarët e tjerë të rritur të familjes dhe prindërit. Aplikanti duhet të japë gjithashtu të dhënat e kontaktit (numri i telefonit dhe adresa) të këtyre personave,
- ▶ **Nëse aplikanti i ka informuar anëtarët** e tjerë të familjes lidhur me faktin se ka paraqitur një kërkesë për marrjen e një lejeje për armë,
- ▶ Profesioni,
- ▶ Të dhënat e punësimit (5 vitet e fundit), duke përfshirë listën e punëdhënësve dhe të dhënat e tyre të kontaktit,
- ▶ Shërbimi ushtarak, duke përfshirë pjesëmarrjen në konflikte të armatosura.



## **Njoftimi i anëtarëve të familjes rreth aplikimit/kërkesës së paraqitur**

Njoftimi i partnerëve intimë dhe anëtarëve të tjerë të familjes, veçanërisht i atyre që jetojnë në të njëjtën banesë, rreth një aplikimi/kërkesë të paraqitur për blerjen/përftimin e armëve të zjarrit, mund të jetë një hap i rëndësishëm në parandalimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje. Njoftimi mund të bëhet një pjesë integrale e procedurës së miratimit të aplikimit. Në këtë rast, është e nevojshme që partnerëve intimë dhe anëtarëve të tjerë të familjes t'u jepen të dhënat e kontaktit të oficerit kompetent të cilit mund t'i referohen në rast se kanë shqetësime lidhur me blerjen e armëve. Çdo informacion i marrë nga partnerët intimë dhe anëtarët e tjerë të familjes duhet të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe nuk duhet ndërmarrë asnjë hap që mund të vërë në rrezik sigurinë e tyre.

Në Kanada, njoftimi i bashkëshortit/bashkëshortes është futur si një kërkesë e detyrueshme në procesin e marrjes së një lejeje për mbajtjen e një arme. Më konkretisht, nëse individët në Kanada dëshirojnë të marrë një leje për armë, pjesë e formularit të aplikimit është edhe specifikimi i të dhënave të kontaktit të bashkëshortëve/partnerëve aktualë dhe të mëparshëm (të 2 viteve të fundit). Gjithashtu, ata duhet të nënshkruajnë një seksion të aplikimit me të dhënat e tyre të kontaktit. Në rast se ky seksion nuk nënshkruhet, Policia duhet të informojë bashkëshortët/partnerët aktualë dhe të mëparshëm rreth aplikimit. Gjithashtu, bashkëshortëve/partnerëve aktualë dhe të mëparshëm u jepen informacione dhe të dhënat e kontaktit të personit që mund të kontaktojnë në rast se kanë shqetësime lidhur me aplikimin për leje për armë.

Në Zelandën e Re, çdo aplikant duhet të paraqesë të paktën dy persona referencë në aplikim dhe informohet se këta persona do të intervistohen gjatë procesit të përcaktimit të përshtatshmërisë së aplikantit për të zotëruar ose jo një armë zjarri. Një nga personat referencë duhet të jetë partneri/partnerja, nëse ka, ose një tjetër person i afërm i familjes (një nga prindërit). Personi i dytë referencë mund të jetë një person që nuk ka lidhje familjare me aplikantin, por që e njeh mirë atë (minimumi tre vite) dhe që mund të dëshmojë rreth karakterit dhe përshtatshmërisë së aplikantit për të zotëruar një armë. Për më tepër, aplikantët duhet të japin të dhënat e kontaktit të ish-bashkëshorteve, ose të partnereve të tyre me të cilat kanë pasur një "marrëdhënie të ngjashme me martesën" gjatë 5 viteve të fundit, pasi edhe këto persona do të intervistohen.

## ▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM

Ish-bashkëshortet dhe partneret njihen me aplikantin dhe mund të cenohen seriozisht nga aplikantët që kanë akses në armë zjarri. Për më tepër, ato mund të kenë gjithashtu marrëdhënie dhe mosmarrëveshje të vazhdueshme me aplikantët, si pasojë e marrëveshjeve për kujdesin për fëmijët dhe marrëveshjeve të tjera të brendshme.

Nëse aplikanti është i divorcuar, jepni informacion se kur ka hyrë në fuqi divorci. Nëse është i ndarë, jepni informacion se kur ka ndodhur ndarja.

Në rastin e ish-bashkëshorteve ose partnereve, kontrolloni nëse ka ndonjë mosmarrëveshje të vazhdueshme, si kujdestaria e fëmijëve, çështje të lidhura me pronat etj.

Konsultohuni me qendrën përkatëse për punë sociale ose me një organizatë vendore të shoqërisë civile që ofron mbështetje për viktimat e mbijetuar të dhunës në familje (strehëz, linjë telefonike/shërbim i ndihmës, mbështetje ligjore dhe psikosociale etj.) dhe diskutoni për informacionet që mund të zotërojnë.

**Në situatat kur kontrollet e sigurisë paraqesin rrezikshmëri, organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë mbështetje mund të jenë vende ku vendosen kontakte të sigurta dhe krijohet besim.**

## ▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM

Shpeshherë, dhuna nga partneri intim vazhdon edhe pas divorcit apo ndarjes. Partnerët abuzues kanë tendencën që të përdorin një gamë të gjerë strategjish dhe sjelljesh të dhunshme për të rivendosur kontrollin dhe pushtetin mbi viktimën.

Largimi nga abuzuesi është koha më e rrezikshme për një viktimë të dhunës në familje, pasi dhuna mund të përshkallëzohet. Nëse autori dyshon ose dëgjon se partnerja po planifikon ta lërë, ai mund t'i trembet faktit se mund të humbasë pushtetin dhe kontrollin dhe shpeshherë, do të rrisë përdorimin e dhunës.

Studimet e kryera së fundmi në rajon kanë treguar se periudha ndërmjet momentit të largimit nga autori dhe vrasjes së grave të larguara varion nga disa ditë deri në dy vjet.

## Arsyeja për marrjen e armëve të zjarrit

Gjatë shqyrtimit të një aplikimi dhe të pajtueshmërisë së tij me kërkesat e përcaktuara nga ligji, duhet treguar kujdes në trajtimin e rasteve kur aplikanti paraqet një arsye të pranueshme për zotërimin e armëve të zjarrit, por mund të ketë  **motive të fshehta**. Policia duhet të kryejë hetime të arsyeshme për të verifikuar arsyet e aplikantit për zotërimin e armëve të zjarrit.<sup>20</sup>

**Gjatë vlerësimit të justifikueshmërisë së çdo aplikimi, kini parasysh se zotërimi i armëve të zjarrit është një mundësi e parashikuar nga ligji, e cila shoqërohet nga një sere detyrimesh të rrepta.**

## Precedentët penalë dhe kundërvajtjet

**Për sa i përket precedentëve penalë dhe kundërvajtjeve,** sigurohuni që të kontrolloni:

- ▶ A është dënuar aplikanti për ndonjë vepër penale, duke përfshirë për veprat penale të parashikuara në ligjin “Për armët”? A është dënuar ndonjëherë aplikanti për dhunë në familje, përdhunim, ngacmim dhe abuzim seksual, apo për përndjekje? Nëse po, jepni një përshkrim të shkurtër, duke përfshirë informacion për kohën kur aplikanti është dënuar ligjërisht, veprat penale të kryera, llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit, si dhe çdo informacion tjetër me rëndësi.
- ▶ A ka ndonjë procedim të hapur penal ndaj aplikantit? Nëse po, përshkruajeni shkurtimisht.
- ▶ A është dënuar aplikanti për ndonjë kundërvajtje, veçanërisht për kundërvajtje të lidhura me dhunën në familje (sipas rastit), rendin dhe qetësinë publike, ose për ato të parashikuara në ligjin “Për armët”? Nëse po, jepni një përshkrim të shkurtër, duke përfshirë informacion për kohën kur aplikanti është dënuar ligjërisht, veprat penale të kryera, llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit, si dhe çdo informacion tjetër me rëndësi.
- ▶ A ka ndonjë procedim të hapur për kundërvajtje ndaj aplikantit? Nëse po, përshkruajeni shkurtimisht.
- ▶ Në rastet kur ndaj personit janë ngritur akuza penale, të cilat nuk kanë rezultuar në

dhënien e një dënimi, ose në nisjen e procedimit, specifikoni kohën, veprimet, një përshkrim të shkurtër dhe rezultatin e tyre (shkarkim nga puna, pezullim ose mbyllje e procedurave, parashkrim, shfajësim). Jepni përshkrime të shkurtra, veçanërisht nëse rastet lidhen me dhunën në familje, përdhunimin, ngacmimin dhe abuzimin seksual, ose përndjekjen. Kjo vlen veçanërisht për akuzat që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave dhe aktet e dhunshme ndaj grupeve të ndara, për shembull, sipas përkatësisë etnike, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, moshës, fesë.

- ▶ Në rastet kur ndaj personit janë ngritur akuza për shkelje, të cilat nuk kanë rezultuar në dhënien e një dënimi, ose në nisjen e procedimit, specifikoni kohën, veprimet, një përshkrim të shkurtër dhe rezultatin e tyre (shkarkim nga puna, pezullim ose mbyllje e procedurave, parashkrim, shfajësim). Jepni përshkrime të shkurtra, veçanërisht nëse lidhen me dhunën në familje ose dhunën në përgjithësi.
- ▶ A ka qenë ndonjëherë aplikanti objekt i ndonjë mase të menjëhershme ose mbrojtëse (p.sh., urdhër mbrojtjeje dhe masa të tjera të përkohshme), veçanërisht për dhunë në familje? Jepni një përshkrim të shkurtër.
- ▶ Përfshini gjithashtu informacione për masat mbrojtëse të lëshuara sipas ligjeve të tjera.
- ▶ Specifikoni nëse ka pasur ndonjë procedim në lidhje me mizorinë ndaj kafshëve, pavarësisht nga rezultati.
- ▶ Për aplikantët nën moshën 30 vjeç, kushtojuni vëmendje të veçantë procedimeve që lidhen me:
  - drejtimin e rrezikshëm ose të pakujdesshëm të automjetit,
  - dhunën ndaj bashkëmoshatarëve, veçanërisht bullizmin,
  - dhunën në aktivitete sportive,
  - abuzimin me substancat.

## ▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM

Në disa raste, ekziston një periudhë relativisht e shkurtër e përcaktuar me ligj, në përfundim të së cilës, dënimet për kundërvajtje ose vepra penale të caktuara fshihen nga regjistrat pas ndodhjes dhe procedimit penal të tyre. Kjo mund të krijojë rrezikun që leja për marrjen e armëve të zjarrit t'i lëshohet një personi që ka kryer dhunë në familje, por të cilit i është hequr dënimi nga regjistrat përkatës. Kjo gjë mund të përbëjë një vendim me rrezik të lartë.

### Regjistrat operacionalë të policisë

- ▶ A janë raportuar ndonjëherë aplikantët në polici për dhunë në familje? Nëse po, përshkruani shkurtimisht ngjarjen, duke përfshirë kohën dhe atë që ka ndodhur, si dhe rezultatin e procedimit. Sigurohuni që të përfshini të gjitha ngjarjet pavarësisht rezultatit.
- ▶ A është raportuar ndonjëherë aplikanti në polici për përndjekje, ngacmim apo dhunë seksuale, duke përfshirë ngacmim dhe abuzim?
- ▶ A është raportuar ndonjëherë aplikanti në polici për mizori ndaj kafshëve?
- ▶ A ka qenë aplikanti i përfshirë në ndonjë incident që është raportuar në polici, apo në ndonjë incident që është raportuar në polici nga vetë aplikanti? Nëse po, përshkruajeni shkurtimisht.
- ▶ A ka pasur sjellje të dhunshme në ndonjë prej këtyre incidenteve? Nëse po, përshkruajini.
- ▶ A ka qenë ndonjëherë aplikanti i arrestuar dhe/ose i ndaluar dhe/ose objekt i ndonjë ndërhyrjeje tjetër policore?
- ▶ A ka të dhëna për sjellje të dhunshme në kontekstin e huliganizmit?
- ▶ A ka informacione për raste të mosbindjes ndaj urdhrave të oficerëve të policisë apo për ofendim të oficerëve të policisë?

Kushtojuni vëmendje të veçantë procedimeve/informacioneve që kanë të bëjnë me aspektet në vijim (veçanërisht për aplikantët nën 30 vjeç):

- ▶ aktet e dhunshme ndaj grave dhe anëtarëve të grupeve të caktuara të ndara, për shembull, sipas përkatësisë etnike, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, moshës, fesë etj.
- ▶ veprat e mëparshme penale në moshë të mitur,
- ▶ lidhjet me bandat dhe huliganizmin,
- ▶ dhunën ndaj bashkëmoshatarëve, veçanërisht bullizmin,
- ▶ dhunën në aktivitete sportive,
- ▶ abuzimin me substancat, duke përfshirë alkoolin ose drogat, çka mund të jetë tregues i gjykimit të dobët dhe humbjes së vetëkontrollit,
- ▶ drejtimin e rrezikshëm, ose të pakujdesshëm të automjetit,
- ▶ krimet kibernetike,
- ▶ mizorinë ndaj kafshëve, veçanërisht shkaktimin e vuajtjeve ose lëndimeve.

## **Të dhënat nga regjistri i armëve të zjarrit**

- ▶ A zotëron apo ka zotëruar më parë aplikanti armë zjarri?
- ▶ Jepni informacion mbi aplikimet e mëparshme për licencë/autorizim/leje për armë zjarri, nëse ka. Sipas rastit, jepni informacion mbi arsyet e refuzimit të mëparshëm.
- ▶ Sipas rastit, jepni të dhëna, duke përfshirë arsyet, për çdo sekuestrim/konfiskim të armëve të zjarrit të aplikantit, për revokimin e lejes, ose për kthimin e armëve të sekuestruara të zjarrit tek aplikanti.

## ▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM

Edhe pse çdo dënim penal ose dënim për kundërvajtje me elemente dhune do të rezultojë në refuzimin e kërkesës për përfitim të armëve të zjarrit, gjatë shqyrtimit të aplikimit duhen marrë në konsideratë të gjitha sjelljet dhe provat e tjera që mund të mos jenë shoqëruar me një dënim, por që mund të jenë tregues të papërshtatshmërisë së aplikantit, si dhe të ekzistencës së rrethanave në të cilat armët e zjarrit mund të keqpërdoren, duke përfshirë në kontekstin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Në këtë aspekt, modeli i sjelljes do të përcaktojë nëse ka një burim rreziku. Megjithatë, mund të ketë edhe raste kur incidente të izoluara do të vënë në pikëpyetje përshtatshmërinë/papërshtatshmërinë e një personi për të zotëruar armë zjarri. Në përgjithësi, modeli i sjelljes së dhunshme ose antisociale, apo i abuzimit, duhet të merret më seriozisht se sa një incident i vetëm.<sup>21</sup> Megjithatë, incidentet e izoluara nuk duhet të shpërfillen në vlerësimin e personit në fjalë dhe të përshtatshmërisë së tij për të zotëruar një armë zjarri.

## Vizitat në terren dhe intervistat<sup>22</sup>

Shqyrtimi i kërkesave duhet të përfshijë realizimin e intervistave ose të kërkimeve gjithëpërfshirëse, veçanërisht me partnerët intimë, aktualë ose të mëparshëm, si dhe me anëtarët e familjes, miqtë, fqinjët ose bashkëpunëtorët e aplikantit, përpara miratimit ose rinovimit të lejes për armë zjarri. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ka informacione që tregojnë ekzistencën e abuzimit dhe dhunës në familje, apo informacione të tjera që mund të tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren. Reagimi i policisë duhet të jetë në përputhje me rrezikun e përfshirë dhe duhet treguar kujdes në shqyrtimin e çdo rasti sipas karakteristikave të tij.<sup>23</sup>

Gjatë vizitave në terren dhe intervistave, është e nevojshme që të bisedoni me një numër të barabartë të burrave dhe grave nga ambienti familjar, si dhe nga ambienti i punës dhe lagja, pas kështu mund të merren këndvështrime dhe informacione të ndryshme rreth modeleve të sjelljes së aplikantit.

Vendimi ndaj kërkesës për të marrë një armë zjarri nuk duhet të mbështetet vetëm në bindjet e krijuara kur analizohet përshtatshmëria e aplikantëve për të zotëruar armë zjarri pa rrezikuar sigurinë ose qetësinë publike. Kjo është veçanërisht e rëndësishme

për incidentet e dhunës në familje, të cilat, shpeshherë, nuk shoqërohet me marrjen e një dënimi, siç u diskutua më parë. Për rrjedhojë, oficerët e caktuar duhet të jenë të vetëdijshëm se gjatë shqyrtimit të incidenteve në familje mund të marrin parasysht dëshmitë verbale të pavërtetuara dhe nuk duhet të mbështeten vetëm te bashkëshortët/partnerët.<sup>24</sup> Dëshmitë verbale të pavërtetuara mund të përfshijnë dëshmitë e oficerëve të policisë që kanë qenë pjesë e vendngjarjes së incidenteve në familje ose informacione të tjera të rëndësishme nga burime të tjera, duke përfshirë, nga qendrat për punë sociale, institucionet e kujdesit shëndetësor, shërbimet e ndihmës dhe të mbështetjes së specializuar për gratë që janë viktime të dhunës dhe dhunës në familje (linjat telefonike/shërbimet e ndihmës, shtëpitë e sigurta, strehëzat), si dhe organizatat e tjera të grave të angazhuara në mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje.

Kur planifikohet një verifikim i së shkuarës nëpërmjet vizitës në terren, rekomandohet që të përfshihen **dy oficerë policie, një mashkull dhe një femër**, për t'u siguruar se të gjithë të intervistuarit e mundshëm ndihen komodë për të diskutuar çështje potencialisht të ndjeshme.

Nëse në institucionin tuaj përdoret një listë kontrolli/udhëzues për verifikimin e së shkuarës përmes vizitave në terren dhe intervistave, ndiqni udhëzimet e tyre, por gjithashtu merrni parasysht dhe përfshini temat/çështjet e renditura më poshtë nëse nuk mbulohen nga lista e përdorur në juridiksionin tuaj.

Rekomandohet që vizitat në terren të përfshijnë disa intervista, duke përfshirë me:

- ▶ aplikantin,
- ▶ partnerin/en, bashkëshortin/en e aplikantit,
- ▶ ish bashkëshortin/en ose partnerin/en e aplikantit, veçanërisht nëse janë divorcuar së fundmi,
- ▶ anëtarët e tjerë të familjes (pra, prindërit, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes që jetojnë së bashku me aplikantin),
- ▶ personat që njihen me aplikantin (pra, fqinjët, kolegët e punës, anëtarët e shoqatave sportive/të gjuetisë, studentët në rastin e aplikantëve të rinj etj.).

Intervistat mund të sigurojnë informacion të besueshëm që do të lehtësojë vlerësimin e përshtatshmërisë së aplikantit për të marrë një leje për armë zjarri. Ato gjithashtu ndihmojnë



në identifikimin e rrethanave që mund të tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, duke përfshirë në dhunën në familje. Një vlerësim i tillë mund të jetë vendimtar për çdo vendim të informuar lidhur me dhënien ose jo të miratimit për marrjen e armëve të zjarrit.

Të intervistuarit duhet të jenë të vetëdijshëm se prej tyre nuk pritet që të japin opinione prej eksperti, por thjesht të ndajnë mendimet dhe informacionet që kanë, të cilat do t'u vinë në ndihmë punonjësve të policisë në procesin e vendimmarrjes.<sup>25</sup> Gjithashtu, atyre duhet t'u jepet mundësia që ta refuzojnë intervistën.

Për rezultate maksimale, intervistat duhet të strukturohen dhe të organizohen rreth shqetësimeve kryesore të diskutuara më lart.

## **Intervista me aplikantin**

Intervista duhet të realizohet gjithmonë përpara dhënies së lejes për një person që aplikon për herë të parë, si dhe duhet të verifikojë dhe përcaktojë nëse janë përmbushur plotësisht kërkesat për ruajtjen e sigurt të armëve të zjarrit.

Intervista mund të ofrojë një mundësi për të mësuar më shumë rreth personalitetit të aplikantit, sjelljes në sferën private, imazhit dhe marrëdhënieve në komunitet etj. Më poshtë jepet një listë me pyetje të sugjeruara që mund të lehtësojnë një intervistë të tillë. Lista nuk është aspak shteruese dhe, në varësi të nivelit të rrezikut të përfshirë, mund të përfshihen një grup shtesë pyetjesh. Kini parasysh se aplikanti do të jetë i përgatitur për intervistën dhe do të përpiqet të lërë një përshtypje të mirë.

### **Aplikimi për leje për armë zjarri**

- ▶ A mund ta shtjelloni pak më tepër interesin dhe arsyen për marrjen e një arme zjarri?
- ▶ Nëse arsyeja lidhet me çështjet e sigurisë personale, kërkoni nga aplikanti që ta shtjellojë përgjigjen dhe të japë prova për ta mbështetur këtë pretendim. Nëse si arsye jepet gjuetia apo ndonjë hobi/sport tjetër, të merret në konsideratë realizimi i të paktën një interviste me personat nga shoqata e gjuetisë apo klubi sportiv.
- ▶ A e keni informuar bashkëshortin/en, partnerin/en tuaj se keni paraqitur një kërkesë për të marrë armë zjarri? A i keni informuar anëtarët e tjerë të familjes (anëtarët e rritur që jetojnë me aplikantin, duke përfshirë fëmijët) rreth aplikimit?
- ▶ Çfarë mendimi kanë ata?

## **Personaliteti i aplikantit dhe niveli i përgjithshëm i kënaqësisë në jetë**

- ▶ Përshkruani veten me pak fjalë (social, i qetë, i lumtur, serioz, tradicional, “fanatik”, impulsiv etj.).
- ▶ Si e kaloni zakonisht kohën e lirë? A keni ndonjë hobi?
- ▶ A konsumoni alkool ndonjëherë? A luani kumar?
- ▶ A zemëroheni lehtësisht? Në çfarë lloj situatash? Si silleni kur jeni të zemëruar?
- ▶ Çfarë ju bezdis më shumë?
- ▶ A jeni të punësuar? Nëse po, pyesni: Jeni të kënaqur me karrierën, marrëdhënien dhe komunikimin me shefin dhe kolegët tuaj? A jeni të kënaqur me të ardhurat që merrni?

## **Jeta në familje dhe marrëdhëniet brenda familjes**

- ▶ Si do e përshkruanit marrëdhënien me partnerin/en, bashkëshortin/en tuaj?
- ▶ A është partneri/ja, bashkëshorti/ja juaj i/e punësuar?
- ▶ A ka bashkëshorti/ja juaj një rreth të gjerë shoqëror? A kalon shumë kohë ai/ajo me ata?
- ▶ A ka situata kur jeni xhelozë apo keni dyshime rreth partnerit/es tuaj?
- ▶ A ka ai/ajo marrëdhënie të ngushta me familjen e tij/saj? A janë ata në kontakt të vazhdueshëm?
- ▶ Si do e përshkruanit marrëdhënien tuaj me anëtarët e tjerë të familjes, duke përfshirë me fëmijët?
- ▶ Kush është “kryetari i familjes” kur bëhet fjalë për vendime të rëndësishme?
- ▶ Kush është përgjegjës për fëmijët në familjen tuaj?
- ▶ Si ndiheni kur dikush në familje nuk i respekton zgjedhjet/vendimet tuaja?

- ▶ Si i zgjidhni konfliktet me partnerin/en, bashkëshortin/en ose anëtarët e tjerë të familjes?
- ▶ Çfarë masash/dënimesh disiplinore merrni kundrejt fëmijëve tuaj?

### **Në rast se aplikanti është divorcuar/ndarë:**

- ▶ Kur jeni divorcuar/ndarë?
- ▶ A keni fëmijë nga martesat/marrëdhëniet e mëparshme?
- ▶ Si ka ndikuar divorci te ju?
- ▶ A keni kontakte me ish partnerin/en tuaj? A e paguani rregullisht detyrimin financiar ndaj partnerit/partneres?
- ▶ A keni probleme me ish bashkëshortin/en, partnerin/en tuaj?

### **Jeta në komunitet**

- ▶ A keni një rreth të gjerë shoqëror?
- ▶ Si do ta përshkruanit marrëdhënien tuaj me fqinjët? A keni ndonjë fqinj që ju bezdis? Nëse po, pse?
- ▶ Si do e përshkruanit marrëdhënien tuaj me kolektivin e punës (shefin, kolegët)?
- ▶ Si i zgjidhni konfliktet me kolegët, fqinjët, miqtë?
- ▶ A e keni kryer shërbim ushtarak? A jeni përfshirë në ndonjë konflikt të armatosur? Nëse po, më tregoni më shumë rreth tij.
- ▶ A jeni tifoz i ndonjë klubi futbollit? A shkonit në aktivitete sportive?
- ▶ Pyeteni aplikantin nëse është i anëtarësuar në grupe të ndryshme (fetare, profesionale, për hobi).

## ▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM

Nuk është e pazakontë që personat e dhunshëm në shtëpi të sillen ndryshe në sferën publike dhe të cilësohen nga kolegët dhe të njohurit si të respektuar, të përkushtuar ndaj familjes etj.

Vëzhgoni me kujdes sjelljen e aplikantit gjatë intervistës dhe mbani shënime gjatë intervistës ose menjëherë pas intervistës për të siguruar regjistrimin e përshtypjeve tuaja.

Zakonisht, oficerët e policisë u kërkojnë aplikantëve të rekomandojnë një person me të cilin duhet të flasin gjatë verifikimit të së shkuarës. Megjithatë, oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të mos flasin vetëm me personat e rekomanduar nga aplikanti.

### Intervista me bashkëshortin/en, partnerin/en

Intervistat me partnerë që mund të jenë viktimat e dhunës në familje mund të jenë vendimtare në kryerjen e një vlerësimi të saktë të aplikimit. Siç u diskutua më lart, bashkëshortët dhe partnerët aktualë dhe të mëparshëm njihen mirë me aplikantin dhe mund të cenohen seriozisht nga aplikantët që kanë akses në armë zjarri. Për më tepër, ata mund të kenë gjithashtu marrëdhënie të vazhdueshme me aplikantin, si pasojë e marrëveshjeve për kujdesin për fëmijët dhe marrëveshjeve të tjera të brendshme, ose mund të kenë mosmarrëveshje me të.

**Oficerët e policisë duhet të marrin në konsideratë elementin e ndjeshmërisë gjatë këtyre intervistave dhe duhet të kenë parasysh se viktimat e dhunës në familje mund të mos jenë të gatshme të flasin hapur me policinë nga frika e dhunës së mëtejshme ose hakmarrjes. Informacioni i dhënë gjatë intervistës duhet të trajtohet si konfidencial.<sup>26</sup> Gjithashtu, atyre duhet t'u jepet mundësia që të mos marrin pjesë në intervistë. Kjo vlen veçanërisht për viktimat e dhunës, siguria e të cilave mund të cenohet akoma më shumë në rastin e realizimit të një interviste. Nëse vlerësohet se realizimi i intervistës mund të përbëjë kërcënim ndaj sigurisë së tyre, atëherë duhet të mbështeteni në burime të tjera informacioni. Në çdo rast, viktimat ato duhet të informohen rreth aplikimit të paraqitur dhe duhet të pajisen me të dhënat e kontaktit të nëpunësit përkatës.**

Oficerët duhet të trajnohen siç duhet për t'u siguruar se i njohin treguesit e abuzimit

në familje dhe dinë se si t'i mbështesin viktimat dhe të garantojnë sigurinë e tyre. Oficerët e policisë duhet të trajnohen që të dallojnë format e ndryshme të dhunës, duke përfshirë dhunën në familje. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm se mund të nevojitet të ndërmerren hapa aktivë për mbrojtjen e partneres së aplikantit nga hakmarrjet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse partnerja intervistohet në lidhje me aplikimin dhe jep informacion që çon në refuzim ose revokim të lejes, pasi aplikanti mund të fajësojë partneren e tij dhe të përdorë dhunë.<sup>27</sup> Gjatë kryerjes së intervistave me partnerët, siguria e tyre ka rëndësi maksimale dhe nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që mund ta komprometojë atë.

Rekomandohet që në rastet kur aplikanti është mashkull, intervista me bashkëshorten/partneren e aplikantit të kryhet nga një oficer policie femër. Kjo duhet t'u mundësojë grave që të ndihen komode, të flasin hapur dhe sinqerisht, pa asnjë shqetësim apo frikë.

Sigurohuni që intervista me partneren/bashkëshorten e aplikantit të kryhet **privatisht**; është tejet **e rëndësishme që të garantohet privatësi dhe konfidencialitet**. Të intervistuarve duhet t'u ofrohen një sërë mundësish, si p.sh., mundësia që intervista të kryhet në shtëpinë e tyre kur aplikanti të mos jetë i pranishëm, në komisariatit e policisë, nëpërmjet telefonit, ose në një vend tjetër dhe në kohën e përshtatshme për to. Bashkëshortja/partnerja duhet të informohet se intervista është **konfidenciale** dhe është vetëm një nga pjesët e procesit të verifikimit të së shkuarës.

Intervista është një mundësi për të **njoftuar bashkëshortët dhe partnerët e mëparshëm dhe aktualë** për paraqitjen e aplikimit për leje për armë zjarri, në rast se nuk janë njoftuar nga aplikanti.

### **Aplikimi për leje për armë zjarri**

- ▶ A jeni informuar nga aplikanti rreth aplikimit të tij për leje për armë zjarri?
- ▶ Çfarë mendimi keni për arsyet e tij për të zotëruar një armë zjarri?
- ▶ A keni ndonjë shqetësim në këtë aspekt (p.sh., a keni frikë për sigurinë tuaj ose të fëmijëve)? Na tregoni pak më shumë rreth kësaj.

### **Të përgjithshme**

- ▶ Përshkruani aplikantin me pak fjalë (social, i qetë, i lumtur, serioz, tradicional, “fanatik”...)

## **Jeta në familje dhe marrëdhëniet brenda familjes**

- ▶ Si do e përshkruanit marrëdhënien tuaj me aplikantin?
- ▶ Kush është përgjegjës për fëmijët në shtëpinë tuaj? Përshkruani marrëdhënien e tij me fëmijët.
- ▶ Si i merrni vendimet e rëndësishme në familje? Kush vendos?
- ▶ Si sillet ai kur dikush në familje nuk i respekton zgjidhjet/vendimet e tij?
- ▶ A zemërohet lehtësisht? Si sillet kur zemërohet? A keni frikë nga ai dhe reagimet e tij në situata të tilla?
- ▶ A ka shfaqur shenja të një sjelljeje kontrolluese gjatë marrëdhënies? Nëse po, përshkruani rastet specifike. A ndiheni të lirë të bëni gjithçka që dëshironi pa frikë (për sa i përket daljeve me miqtë, pazarit, grimit dhe veshjes, vizitave në familjen tuaj...)? A është person xheloz?
- ▶ A keni shpesh argumente apo konflikte me aplikantin? Si i zgjidhni ato?
- ▶ A ka qenë ndonjëherë i dhunshëm (kundrejt jush, fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes)? Nëse po, a mund të jepni më tepër detaje?
- ▶ A është aplikanti person impulsiv?
- ▶ A shfaq luhatje të emocioneve, a ka një ndjenjë të vazhdueshme trishtimi apo humbje të interesit për aktivitetet e përditshme? A ka pasur mendime për vetëvrasje së fundmi?
- ▶ A është aplikanti i prirur ndaj alkoolit, drogave apo kumarit?
- ▶ Si i zgjidhni konfliktet me partnerin/en, bashkëshortin/en ose anëtarët e tjerë të familjes?
- ▶ A keni një rreth të gjerë shoqëror?
- ▶ A takoheni rregullisht me miqtë dhe anëtarët e familjes suaj?
- ▶ A mund ta përshkruani marrëdhënien e tij me miqtë, fqinjët dhe kolegët? A është i respektuar në komunitet? A ka mosmarrëveshje me miqtë, fqinjët ose kolegët?

- ▶ Si e kalon kohën e lirë? A ka ndonjë hobi?
- ▶ A ka një rreth të gjerë shoqëror?

### **Jeta në komunitet**

- ▶ A ka aplikanti një rreth të gjerë shoqëror? A ka shfaqur shenja të izolimit social?
- ▶ Si është marrëdhënia e tij/e saj me miqtë, fqinjët dhe kolegët?
- ▶ A ka mosmarrëveshje me ta?

**Vëzhgoni me kujdes sjelljen e tij/saj gjatë intervistës** dhe mbani shënime gjatë intervistës, ose menjëherë pas intervistës, për të siguruar regjistrimin e përshtypjeve tuaja. Nëse vërehen shenja dhune, informoni oficerin e policisë që është përgjegjës për rastet e dhunës në familje/dhunës ndaj grave.

### **▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM**

Partnerëve të aplikantit nuk u kërkohet që të japin miratim ose pëlqim në lidhje me aplikimin për leje për armë zjarri dhe diçka e tillë duhet t'u bëhet e qartë. Përgjegjësia për të marrë vendimin bazuar në të gjitha provat në dispozicion i takon policisë. Megjithatë, nëse bashkëshorti/ja ka ndonjë dyshim ose ngre ndonjë shqetësim, atyre duhet t'u jepet rëndësi maksimale dhe duhet të ndërmerren rishikime shtesë të aplikimit.

### **▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM**

Nëse partnerja e aplikantit beson se abuzuesi mund ta lëndojë atë, çështja duhet të trajtohet si çështje me rrezikshmëri më të lartë. Nga ana tjetër, ka raste kur gratë, pasi kanë përjetuar dhunë për një kohë të gjatë, janë mësuar me dhunën, e minimizojnë atë dhe nuk janë në gjendje ta njohin rrezikun.

## Intervista me ish partnerët/et

Siç u diskutua më lart, ish bashkëshortët/et dhe partnerët /et e njohin mirë aplikantin dhe blerja e një arme zjarri nga aplikanti mund të paraqesë një shqetësim serioz për sigurinë e tyre. Nëse ka ndonjë tregues rreziku, rekomandohet të zhvilloni një intervistë me ta. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme në rastet kur divorci ose ndarja ka ndodhur së fundmi. Për më tepër, në raste të tilla, mund të jetë i dobishëm konsultimi me Qendrën vendore të Mirëqenies Sociale. Ekziston një grup pyetjesh për partnerin aktual që mund të shërbejë si bazë për intervistën, por vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe pyetjeve të mëposhtme:

- ▶ Kur jeni divorcuar/ndarë? Çfarë keni përjetuar gjatë procesit të divorcit?
- ▶ A keni kontakte me ish partnerin/en tuaj? A e paguan ai/ajo rregullisht detyrimin financiar?
- ▶ A keni probleme me ish bashkëshortin/en, partnerin/en tuaj?
- ▶ A ka qenë ndonjëherë i dhunshëm (kundrejt jush, fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes)? Nëse po, a mund të jepni më tepër detaje?
- ▶ A keni ndonjë shqetësim në lidhje me kërkesën për leje për armë zjarri të paraqitur nga ish partneri juaj?

## Intervista me anëtarët e rritur të familjes, duke përfshirë prindërit e aplikantit

Sipas rastit, prindërit e aplikantit mund të japin informacione të rëndësishme për personalitetin dhe përvojat e aplikantit, në veçanti, lidhur me fëmijërinë dhe edukimin e tij/saj.

- ▶ A jeni informuar nga aplikanti rreth aplikimit të tij/saj për leje për armë zjarri?
- ▶ A keni ndonjë shqetësim në lidhje me kërkesën e paraqitur për leje për armë zjarri?
- ▶ Përshkruajeni aplikantin gjatë fëmijërisë.
- ▶ A ka qenë përshtatur mirë në shkollë? A ka pasur shumë miq? A ka qenë ndonjëherë viktimë e dhunës nga bashkëmoshatarët?



- ▶ A ka pasur marrëdhënie në çift?
- ▶ Si reagonte më parë kur i mohojë diçka dhe si reagon tani?
- ▶ A ka qenë ndonjëherë pjesë e ndonjë bande, grupi huliganësh apo e grupimeve të ngjashme?
- ▶ A është disiplinuar përmes përdorimit të dhunës në fëmijëri?
- ▶ A ka pasur ndonjëherë mendime për vetëvrasje apo probleme me shëndetin mendor?
- ▶ Si kanë qenë qëndrimet e tij ndaj grave?
- ▶ Po sjelljet ndaj grupeve të caktuara, për shembull, të ndara sipas përkatësisë etnike, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, moshës dhe fesë?
- ▶ A ka qenë i prirur ndaj abuzimit me substancat, duke përfshirë alkoolin dhe drogat?
- ▶ A e ka drejtuar ndonjëherë automjetin në mënyrë të pakujdesshme?
- ▶ A ka qenë ndonjëherë mizor me kafshët?

## **Intervista me persona të tjerë (fqinjët, kolegët, anëtarët e shoqatave sportive dhe/ose gjuetisë)**

Intervistimi i fqinjëve, kolegëve dhe anëtarëve të shoqatave sportive dhe/ose gjuetisë mund të kontribuojë në një panoramë më të gjerë të aplikantit dhe personalitetit/karakterit të tij, si dhe mund të hedhë dritë mbi çdo mosmarrëveshje apo argument që mund të jetë tregues i një situatë rreziku, veçanërisht nëse ndodhin në kuadrin e marrëdhënieve me fqinjët.

- ▶ Si vepron/sillet aplikanti në komunitet, lagje, në punë dhe në klubet sportive/të gjuetisë?
- ▶ Na tregoni rreth marrëdhënieve/ndërveprimeve të tij me miqtë/kolegët dhe fqinjët?  
A ka shpesh debate me ta?
- ▶ A është i prirur ndaj konflikteve? A jeni në dijeni të ndonjë situatë në të cilën është treguar i dhunshëm, duke përfshirë në marrëdhëniet familjare?
- ▶ A ka aplikanti probleme me abuzimin me alkoolin, drogën apo kumarin?

Në rastet kur arsyeja e aplikimit është gjuetia, kërkoni informacion nga përfaqësuesi i shoqatës së gjuetisë rreth faktit nëse aplikanti është një anëtar aktiv i kësaj shoqate, merr pjesë rregullisht në veprimtaritë dhe turnetë e organizuara prej saj, kohës kur aplikanti është anëtarësuar në shoqatë, si dhe rreth përfshirjes së mëparshme të tij/saj në incidente gjatë veprimtarive të gjuetisë dhe shenjëtarisë, rreth çdo mase disiplinore të marrë ndaj aplikantit, si dhe rreth çdo mase disiplinore të vendosur.

## Raporti për verifikimet e së shkuarës

Në raport duhet të përcaktohet shprehimisht nëse ka rrethana që tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, veçanërisht në kontekstin e:

- ▶ dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave,
- ▶ rreziqeve të lidhura me grupet më të rrezikuara ose të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, veçanërisht nga meshkujt e rinj në moshë.

Duhet të shmangët çdo paqartësi.

Nëse informacioni i mbledhur nuk ofron prova të mjaftueshme, por hedh dyshime mbi përshtatshmërinë e personit që do t'i jepet një armë zjarri, duhet të kryhen hetime shtesë për të përcaktuar nëse ka ose jo prova të mëtijshme që tregojnë se personi do të ishte i papërshtatshëm për të zotëruar një armë zjarri.

## **Kutia 1: Kryeni hetime të tjera, duke përfshirë kontrollin e mediave sociale dhe të aktivitetit në internet**

Llogaritë e aplikantëve në mediat sociale mund të ofrojnë informacione të rëndësishme për karakterin dhe sjelljen e tij/saj dhe mund të tregojnë nëse ka ndonjë shqetësim që duhet të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit. Duhet t'i kushtohet vëmendje çdo veprimtarie që mund të ngrejë dyshime.

Krahas mediave sociale, merrni në konsideratë aktivitetin në internet të aplikantit, si p.sh., në forume, dhomat e bisedave dhe komunitetet online.

Për sa i përket pranisë në media sociale dhe aktivitetit në internet, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë çdo përmbajtjeje që:

- ▶ Nxit dhe vlerëson dhunën në çdo kontekst,
- ▶ Përmban qëndrime mizogjene, gjuhë urrejtjeje ndaj grave dhe vajzave, ose paragjykime të tjera të shprehura fuqishëm ndaj grave,
- ▶ Justifikon dhunën ose bën thirrje për dhunë ndaj grave dhe vajzave dhe dhunë me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën, ngacmimin dhe abuzimin seksual,
- ▶ Ka qëndrime pozitive ndaj të shtënave masive, duke përfshirë postime për autorët e të shtënave masive në të shkuarën,
- ▶ Përmban gjuhë urrejtjeje apo qëndrime të dhunshme ndaj grupeve të caktuara, për shembull, të ndara sipas përkatësisë etnike, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, moshës, fesë,
- ▶ Tregon përfshirje në bullizëm kibernetik dhe/ose ngacmim në internet/krim kibernetik,
- ▶ Tregon lidhje me banda,
- ▶ Tregon radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm,
- ▶ Promovon dhunën në aktivitete sportive,
- ▶ Promovon drejtimin e rrezikshëm ose të pakujdesshëm të automjetit,
- ▶ Tregon mizori ndaj kafshëve.



**HAPI 3:**

# Marrja e një vendimi të informuar dhe me ndjeshmëri gjinore

Vendimet për aplikimet duhet të merren në bazë të vlerësimit të të gjithë informacionit përkatës dhe në bazë të karakteristikave individuale të çdo rasti. Për të marrë një vendim të informuar rreth faktit nëse armët e zjarrit mund të keqpërdoren në dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, sigurohuni që të jetë mbledhur i gjithë informacioni përkatës, duke përfshirë nga:

- ▶ Precedentët penalë dhe kundërvajtjet, të dhënat operationale dhe të dhënat e tjera,
- ▶ Regjistrat e policisë,
- ▶ Regjistri i armëve të zjarrit,
- ▶ Vizitat në terren dhe intervistat, duke përfshirë dhe ato me partnerët, sipas rastit,
- ▶ Burimet e tjera të informacionit, si p.sh., prania në mediat sociale dhe aktiviteti në internet.

Kur vlerësoni një aplikim për dhënien e lejes për armë zjarri, qoftë nga perspektiva gjinore, po ashtu edhe në përgjithësi, merrni parasysh faktorët e mëposhtëm që mund të tregojnë rrezik të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore:

- ▶ Të gjitha dënimet e mëparshme për veprat penale dhe kundërvajtjet, në veçanti ato që lidhen me dhunën në familje,
- ▶ Historiku i sjelljeve kriminale ose shkeljeve të rendit dhe qetësisë publike, edhe kur nuk janë shoqëruar me dënim, mund të tregojë rrethana që mund të çojnë në keqpërdorim të armëve të zjarrit,
- ▶ Vendimi ndaj një kërkesë për të marrë një armë zjarri nuk duhet të mbështetet vetëm në bindjet e krijuara kur analizohet përshtatshmëria e aplikantëve për të zotëruar armë zjarri pa rrezikuar sigurinë ose qetësinë publike, si dhe duhet të merren parasysh dëshmitë verbale të pavërtetuara të marra gjatë verifikimit të së shkuarës,
- ▶ Sigurohuni që çdo precedent i dhunës në familje, si dhe çdo sjellje e dhunshme dhe agresive të trajtohet me prioritet maksimal pavarësisht nga rezultati, pasi mund të tregojë rrethana ku armët e zjarrit mund të keqpërdoren,
- ▶ Akuzat/pretendimet ose informacionet e inteligjencës që nuk kanë rezultuar në

dënime mund të jenë prova të papërshtatshmërisë së aplikantit, veçanërisht nëse akuzat/prendimet janë marrë nga burime të ndryshme dhe informacionet e inteligjencës gjykohen të jenë të besueshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për çdo incident që përfshin dhunë ose armë zjarri.

- ▶ Edhe pse modelet e sjelljes së dhunshme ose antisociale apo të abuzimit duhet të merren më seriozisht se një incident i vetëm, incidentet e izoluara nuk duhet të shpërfillen në vlerësimin e personit në fjalë dhe të përshtatshmërisë së tij për të zotëruar një armë zjarri. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për dhunën në familje, e cila karakterizohet nga një nivel i ulët raportimi,
- ▶ Kushtojuni vëmendje të veçantë intervistave të kryera me bashkëshortet/partneret dhe anëtarët e tjerë të familjes, duke përfshirë me ish partneret. Çdo shqetësim i tyre duhet trajtuar me prioritetin më të lartë,
- ▶ Megjithatë, partnerët/et intimë/e mund të mos jenë të gatshëm ose në gjendje të shprehin hapur shqetësimet e tyre; për rrjedhojë, burimet e tjera të informacionit janë shumë të rëndësishme,
- ▶ Çdo precedent i gjuhës së urrejtjes, qëndrimeve armiqësore dhe të dhunshme ndaj grave dhe individëve ose grupeve mbi bazat e përkatësisë etnike, racës, identitetit gjinor, aftësisë të kufizuar, orientimit seksual, moshës apo fesë.
- ▶ Çdo lidhje me banda apo grupe huliganësh, duke përfshirë aktivitete të dhunshme sportive,
- ▶ Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet çdo treguesi të radikalizmit ose ekstremizmit të dhunshëm, ose çdo përmbajtjeje që lidhet me të shtënat masive.
- ▶ Çdo tregues i abuzimit me substancat, duke përfshirë me alkoolin dhe drogat,
- ▶ Të dhënat e policisë për çdo aktivitet që përfshin armë zjarri, veçanërisht për veprat që përfshijnë dhunë, ose për mospërbushjen e kërkesave sipas të cilave është lëshuar leja për armë zjarri, duke përfshirë ato që lidhen me ruajtjen e sigurt të armëve të zjarrit. Këtu përfshihen gjithashtu refuzimet ose revokimet e mëparshme të lejes për armë zjarri.

Në rast se, gjatë shqyrtimit të aplikimit, përcaktohen dhe dokumentohen rrethana që tregojnë se armët e zjarrit mund të keqpërdoren, atëherë nuk duhet të jepet autorizimi për blerjen/marrjen e armëve të zjarrit, siç specifikohet në ligjin “Për armët”. Nëse gjatë procesit të shqyrtimit lindin dyshime për keqpërdorimin e armëve të zjarrit, por nevojiten informacione shtesë, atëherë duhet të nisë një shqyrtim shtesë i aplikimit për të mbledhur prova të mjaftueshme për të përcaktuar nëse ekziston/nuk ekziston një rrezik i keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Vendimmarrja duhet të udhëhiqet nga objektivi parësor, i cili është parandalimi i shkaktimit të dëmeve nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit.

### ▼ TREGOHUNI TË VËMENDSHËM

Nëse aplikimi refuzohet bazuar në treguesit se armët e zjarrit mund të keqpërdoren në dhunën në familje dhe ky informacion është marrë nga partnerë intimë ose nga anëtarë të tjerë të familjes, sigurohuni që aplikanti i refuzuar të mos mësojë në asnjë rrethanë për arsyet e refuzimit pasi kjo gjë mund të vendosë partnerin dhe anëtarin e familjes në rrezik ekstrem dhe mund të komprometojë seriozisht sigurinë e tyre. Këto raste duhet të trajtohen me kujdes maksimal.







**HAPI 4:**

# Monitoroni në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e kushteve ligjore për zotërimin e armëve

Autoritetet duhet të kenë masat e duhura për të monitoruar çdo veprimtari të personit të pajisur me leje, për t'u siguruar se të gjitha informacionet përkatëse janë të disponueshme për të realizuar vlerësimin e vazhdueshëm të përshtatshmërisë dhe kualifikueshmërisë së një individi për të zotëruar një armë zjarri. Është shumë e rëndësishme që oficerët të veprojnë me vendosmëri, veçanërisht lidhur me incidentet në familje dhe ato të dhunës, për të shmangur dhe parandaluar dëmet nga keqpërdorimi i mundshëm i armëve të zjarrit.<sup>28</sup> Pas një incidenti të dhunës në familje ose abuzimit, duhet të kryhet një rishikim i përshtatshmërisë së personit të pajisur me leje për armë zjarri.

Informacioni në lidhje me përshtatshmërinë e një personi të pajisur me leje mund të jepet edhe nga anëtarët e publikut që kanë njohuri me mbajtësin e lejes. Të gjitha këto raportime duhet të hetohen dhe të regjistrohen në mënyrën e duhur. Në rastet kur informacioni i raportuar mund të vërtetohet, duhet të kryhet një rishikim i përshtatshmërisë së personit të pajisur me leje. Raportimet e bëra në mënyrë anonime duhet të trajtohen si inteligjencë dhe duhet të ndërmerren hapa për t'u siguruar se hetimet ose proceset gjyqësore vijuese nuk zbulojnë burimin e informacionit. Si pjesë e hetimit, duhet të ndërmerren gjithashtu hapa për të konstatuar nëse raportimi mund të jetë keqdashës.<sup>29</sup>

Në kuadër të këtij rishikimi të vazhdueshëm, mjekët e përgjithshëm dhe specialistët e shëndetit duhet të informohen rreth detyrimit të tyre ligjor për të raportuar në kohë çdo ndryshim në shëndetin e personit të pajisur me leje për armë zjarri që ndikon në përshtatshmërinë e tij për të zotëruar armë zjarri.

Pas dhënies së një lejeje për armë zjarri, duhet të planifikohen vizita pasuese periodike te aplikanti për të kontrolluar nëse arma e zjarrit ruhet sipas kërkesave ligjore të parashikuara dhe nëse ekzistojnë kushtet për ruajtjen e sigurt të armës.



- 1 Burimi: SEESAC Armed Violence Monitoring Platform
- 2 SEESAC. 2019. Misuse of Firearms in Domestic Violence in South East Europe: Fast Facts.
- 3 SEESAC.2022. In Focus Armed Violence Monitor on Firearm Incidents in the Context of Domestic Violence in SEE in 2019-2021.
- 4 SEESAC.2019. Men and Firearms in South East Europe: Fast Facts.
- 5 Për më shumë informacion, shihni raportin kryesor të "[Vrojtimit të udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave](#)". Ky raport prezanton gjetjet e krahasueshme ndër-rajonale të vrojtimit të OSBE-së për mirëqenien dhe sigurinë e grave, i cili u realizua në vitin 2018 në juridiksione të përzgjedhura në Evropën Lindore dhe Juglindore. Vrojtimi i udhëhequr nga OSBE përfshinte një komponent sasior dhe cilësor dhe u realizua me qëllim sigurimin e të dhënave të krahasueshme rreth formave të ndryshme të dhunës që përjetojnë gratë në fëmijëri dhe gjatë jetës së tyre. Studimi shqyrtoi dhunën që përjetojnë gratë në mjediset e konfliktit dhe të jo konfliktit, si dhe ndikimin që ka dhuna te gratë dhe vajzat, duke përfshirë pasojat afatgjata të saj. Studimi përfshinte pyetje rreth normave dhe qëndrimeve të lidhura me dhunën ndaj grave për të kuptuar më mirë shkaqet themelore të dhunës.
- 6 Përkufizimet në këtë kapitull janë marrë nga Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".
- 7 Për më shumë informacion, shihni raportin kryesor të "[Vrojtimit të udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave](#)". Ky raport prezanton gjetjet e krahasueshme ndër-rajonale të vrojtimit të OSBE-së për mirëqenien dhe sigurinë e grave, i cili u realizua në vitin 2018 në juridiksione të përzgjedhura në Evropën Lindore dhe Juglindore. Vrojtimi i udhëhequr nga OSBE përfshinte një komponent sasior dhe cilësor dhe u realizua me qëllim sigurimin e të dhënave të krahasueshme rreth formave të ndryshme të dhunës që përjetojnë gratë në fëmijëri dhe gjatë jetës së tyre. Studimi shqyrtoi dhunën që përjetojnë gratë në mjediset e konfliktit dhe të jo konfliktit, si dhe ndikimin që ka dhuna te gratë dhe vajzat, duke përfshirë pasojat afatgjata të saj. Studimi përfshinte pyetje rreth normave dhe qëndrimeve të lidhura me dhunën ndaj grave për të kuptuar më mirë shkaqet themelore të dhunës..
- 8 Amnesty International, the International Action Network on Small Arms (IANSA) and Oxfam International. 2005. The Impact of Guns on Women's Lives. Oxford: The Alden Press.
- 9 Shihni: American Psychological Association, Dictionary of Psychology.
- 10 Shihni: Brian Heilman with Gary Barker. 2018. Masculine Norms and Violence. Making the Connections. Promundo.
- 11 SEESAC.2019. Men and Firearms in South East Europe: Fast Facts.
- 12 Shihni: Heilman, B., Barker, G., and Harrison, A. (2017). The Man Box: A Study on Being a Young Man in the US, UK, and Mexico. Washington, DC and London: Promundo-US and Unilever.
- 13 Brian Heilman with Gary Barker. 2018. Masculine Norms and Violence. Making the Connections. Promundo.
- 14 SEESAC. Gender and SALW in South East Europe: Main Concerns and Policy Responses.
- 15 Shihni: Page, Ella. 2009. 'Men, Masculinity and Guns: Can We Break the Link?'. IANSA; Mankowski, Eric. 2013. 'Antecedents to Gun Violence: Gender and Culture'. In Gun violence: Prediction, Prevention, and Policy. American Psychological Association; Bevan, James and Nicholas Florian. 2006. 'Few options but the gun: Angry young men'. In Small Arms Survey 2006: Unfinished Business. Geneva: Small Arms Survey.
- 16 Po aty.
- 17 SEESAC. 2006a. The Rifle has the Devil Inside – Gun Culture in South Eastern Europe.
- 18 Page, Ella. 2009.
- 19 Bevan, James and Nicholas Florian. 2006. 'Few options but the gun: Angry young men'. In Small Arms Survey 2006: Unfinished Business. Geneva: Small Arms Survey.
- 20 Home Office. 2016. Guide on Firearms Licensing Law.
- 21 Po aty, f. 98.
- 22 Ky seksion bazohet gjerësisht në propozimin e Udhëzimeve për zbatimin e dispozitave ligjore për mbajtjen e armëve me qëllim parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim, të hartuar nga UNDP në Serbi, në kuadër të projektit "Redukto rrezikun, Rrit sigurinë - Drejt zhdukjes së keqpërdorimit të AVL-ve në kontekstin e dhunës në familje".
- 23 Po aty, f. 102.
- 24 Po aty, f. 101.
- 25 Po aty, f. 71.
- 26 Po aty, f. 101.
- 27 Po aty, f. 101.
- 28 Po aty, f. 102.
- 29 Po aty, f. 102.







CIP - Каталогизacija u publikaciji  
Nародна библиотека Србије, Београд

623.44

NJË instrument për miratimin me ndjeshmëri gjinore të lejeve për armë  
zjarri / [redaktorët Kosana Beker, Dragan Božanić] : [përkthimi Alba Global].  
- Beograd : UNDP SEESAC, 2024 (Belgrad : Bigraf plus). - 60 str. ; 30 cm

Prevedeno prema: Инструмент за родно осетљиво одобравање дозвола  
за ватрено оружје. - Tiraž 50.

ISBN 978-86-7728-369-8

a) Ватрено оружје

COBISS.SR-ID 147347209



South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse  
for the Control of Small Arms and Light Weapons (SEESAC)

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000 Belgrade, Serbia

Tel: +381 11 415 5300

E-mail: [seesac@undp.org](mailto:seesac@undp.org)

[www.seesac.org](http://www.seesac.org)



Funded by  
the European Union

Working within the framework of:

